

LUMNIJE METANOVIQ, DR. ARTAN HAXHI, DR. TEFË TOPALLI

BOTA E FJALËVE

GJUHË SHQIPE 6

PËR KLASËN E GJASHTË TË SHKOLLËS FILLORE

LIBRI I MËSUESIT/ES

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore

PODGORICË, 2025

LUMNIJE METANOVIQ, DR. ARTAN HAXHI, DR. TEFË TOPALLI,

BOTA E FJALËVE

GJUHË SHQIPE 6

për klasën e gjashtë të shkollës fillore

Libri i Mësuesit

Svijet riječi

ALBANSKI JEZIK 6

Za šesti razred osnovne škole

Priručnik

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

Për botuesin: Mr. Aleksandra Hajduković, drejtoreshë

Kryeredaktor: Mr. Radulle Novović

Redaktor përgjegjës: Llazo Leković

Redaktor: Dimitrov Popović

Recensentë: Mr. Marjan Lulgjuraj

Valbona Hoxhiq

Hana Camaj

Fran Vulaj

Dr. Mitat Hoxha

Lektor: Marjan Lulgjuraj

Dizajni dhe faqosja: Momçilo Qorsoviq

Ilustrimet: Mersiha Resulbegović

Redaktore teknike: Dajana Vukçević

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-303-2573-1
COBISS.CG-ID 36422404

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me vendimin nr. 08/2-119/25-7446-7, datë 16.07.2025

e ka miratuar këtë Komplet të tekstit mësimor për përdorim në shkollat fillore.

Copyright c Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2025

PËRMBAJTA

PLANIFIKIMI DITOR

I	GJUHA AMTARE	5-18
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	5
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	7
3.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	9
II	FJALËFORMIM	19-32
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	12
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	14
3.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	17
III	TELEFONI	33-44
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	19
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
3.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
IV	KLASAT E FJALËVE	45-49
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
V	EMRI	50-59
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
VI	REKLAMA	60-72
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
3.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
VII	MBIEMRI	73-86
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
3.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
VIII	LAJMI DHE LAJMËRIMI	87-96
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
IX	NUMËRORI	97-105
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
X	TEKSTI SHKENCOR POPULLARIZUES	106-109
1.	Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	

XI PËREMRI	110-122
1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2. Planifikimi ditor(Ora e parë dhe ora e dytë)	
3. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XII PËRSHKRIMI	123-126
1. 1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XIII FOLJA	127-134
1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XIV ANKETA	135-142
1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
2. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XV KRYEFJALA	143-146
1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XVI KALLËZUESI	147-150
1. Planifikimi ditor (Ora e parë dhe ora e dytë)	
XVII VLERËSIM I NJOHURIVE (TESTET).....	151-161
ZGJIDHJET	162-210

Planifikimi ditor 1 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Gjuha amtare.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja se punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe:

komunikim,

identitet,

kulturë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

të sqarojë çfarë quhet gjuhë amtare dhe cila është gjuha amtare e tyre;

të sqarojë dallimin e gjuhës amtare nga gjuha zyrtare;

Veprimtaria e nxënësit:

punojnë me teknikën stuhi mendimesh;

identifikojnë gjuhën e tyre amtare;

punojnë me metodën pema e mendimit;

në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim – Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve: Çfarë është gjuha dhe çfarë shprehet me anë të saj?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe me kujdes dëgjojnë shpjegimin e mësimdhënësit.

Mësimdhënësi shpjegon se:

Gjuha është pjesë e pandarë e identitetit të një populli me anë të së cilës shprehet shpirti dhe kultura e tij.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës


Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Gjuha amtare" dhe fton nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin nga jeta sportive në Evropë; u kërkohet të thonë në cilën gjuhë është shkruar

dhe çfarë përfaqëson kjo gjuhë për ne.

Hapi i dytë (Pema e mendimit)

Nxënësit punojnë me metodën pema e mendimit me ndihmën e mësimdhënësit.



Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Ç'është gjuha amtare?
2. Cilat janë veçoritë e gjuhës amtare?
3. Çfarë ka caktuar UNESCO për gjuhët amtare?

Hapi i dytë (rrjeti i diskutimit)

Nxënësit lexojnë detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për gjuhën amtare.

Detyrë shtëpie: Shkruaj një ese kushtuar gjuhës amtare.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Gjuha amtare.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës, TV etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, harta e mendjes;

Fjalët kyçe: komunikim, identitet, kulturë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimimit nxënësit do të jenë të aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të sqarojë çfarë quhet gjuhë amtare dhe cila është gjuha amtare e tyre;
- të sqarojë dallimin e gjuhës amtare nga gjuha zyrtare.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi lëshon në televizor pyetjet e përgatitura me power point.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Pyet nxënësit për rolin dhe rëndësinë e gjuhës amtare.

Nxënësit flasin për rolin dhe rëndësinë e gjuhës amtare.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të punojnë detyrat nga fletorja e punës.

Mësimdhënësi jep sqarime lidhur me detyrën 1.

Nxënësit në fletoren e punës punojnë detyrën 1 nën a, b dhe c.

Hapi i dytë

Mësimdhënësi jep sqarime lidhur me temat e dhëna në fletoren e punës.

Nxënësit në fletoren e punës plotësojnë tekstin. **A “Vendi im” dhe tekstin B “Gjuha ime”.**

Nxënësit lexojnë punimet e tyre dhe vlerësohet punimi më i mirë.

Mësimdhënësi dëgjon punën e nxënësve dhe zgjedh disa punime.

Vlerësohet punimi më i mirë.

Hapi i tretë

Mësimdhënësi lexon detyrën 3 dhe 4 nga fletorja e punës dhe jep udhëzime sipas kërkesave të detyrave.

Nxënësit punojnë detyrën 3 dhe 4 sipas kërkesës.

Diskutohet me nxënësit si u janë përgjigjur kërkesave.


Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(hartë e mendjes)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të plotësojnë hartën e mendjes në tabelë.

Nxënësit me kujdes plotësojnë hartën e mendjes.



Hapi i dytë

Përshkruajnë prej tabele në fletore.

Detyrë shtëpie: Gjeneroni një poezi kushtuar *gjuhës amtare*.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Gjuha standarde dhe gjuha zyrtare.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe: gjuha standarde, gjuha zyrtare.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të tregojë cila është gjuha zyrtare në Mal të Zi;
- të tregojë në cilat zona të Malit të Zi gjuha shqipe ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar;
- të njohë gjuhët zyrtare në shtetet që kufizohen me Malin e Zi.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me teknikën Di, dua të di, mësova;
- identifikojnë gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare;
- në grupe punojnë detyrat;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Nxënësit lexojnë me kujdes tekstet nga libri i nxënësit dhe tregojnë se cili është shkruar në variantin e shqipes standarde dhe cili është në dialekt.

Hapi i dytë (di, dua të di mësova)

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
---------	----	-----------	--------

Gjuha standarde dhe gjuha zyrtare.	Për gjuhën amtare.	Për gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare.	Të dhënat bazë për gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare.
---	--------------------	--	---


Pjesën mësova e plotësojnë në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)


Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë *"Gjuha standarde dhe gjuha zyrtare"*.

Thekson se:



Gjuha shqipe standarde u miratua në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, të mbajtur në Tiranë në vitin 1972.

Ajo u mbështet kryesisht në toskërishten letrare.



Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar edhe kohën për të punuar detyrën e dhënë.

Pasi nxënësit përfundojnë zgjidhjen e ushtrimit të tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i korrigjojnë së bashku.

Grupi I – Pema e mendimit, gjuha standarde.

Grupi II - Pema e mendimit, gjuha zyrtare.

Mësimdhënësi përcjell punën e nxënësve.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Ç'është gjuha standarde?
2. Cilat janë veçoritë e saj?
3. Kur u përcaktua gjuha shqipe standarde?
4. Ç'është gjuha zyrtare?
5. Cilat janë veçoritë e saj?

6. Cili është vendi i gjuhës shqipe në shtetin e Malit të Zi?

Hapi i dytë (rrjeti i diskutimit)

Nxënësit lexojnë detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësit.

Plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare.

Detyrë shtëpie: Cilat janë gjuhët zyrtare të vendeve në kufi me Malin e Zi?

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Gjuha standarde dhe gjuha zyrtare.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe:

gjuhë standarde, gjuhë zyrtare.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të tregojë cila është gjuhë zyrtare në Mal të Zi;
- të tregojë në cilat zona të Malit të Zi gjuha shqipe ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar;
- të njohë gjuhët zyrtare në shtetet që kufizohen me Malin e Zi.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës-nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe fton disa nxënës t'i lexojnë.

Mësimdhënësi pyet nxënësit se ç'është gjuha standarde dhe gjuha zyrtare.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Merr informacion se çfarë dinë nxënësit për gjuhën standarde dhe zyrtare.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(Rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim, punë individuale)

Hapi i parë

Mësimdhënësi lexon detyrën 1 dhe i fton nxënësit ta punojnë në fletoren e punës.

Nxënësit punojnë detyrën 1nën a, b, c sipas kërkesës.

Hapi i dytë

Duke bashkëbiseduar me nxënësit, i fton ata në mënyrë individuale të plotësojnë fletoren e punës dhe u kërkon të gjykojnë.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat në vazhdim dhe plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesave. Mësimdhënësi jep sugjerime kur është e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës
(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Mësimdhënësi i orienton nxënësit për të punuar detyrën dhe dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Nxënësit punojnë detyrën 6 sipas kërkesës, duke shkruar një tekst të shkurtër në gjuhën standarde.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë punimet e veta.

Mësimdhënësi zgjedh punimet më të mira dhe i vlerëson.

Detyrë shtëpie : Shkruani një tekst në gjuhën standarde.

Planifikimi ditor 3 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Dialekti.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di mësova.

Fjalët kyçe:

gegërisht, toskërisht.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mëimit nxënësi do të jetë i aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dallojë gjuhën standarde shqipe dhe varietetet jostandarde (në dialekt), si dhe të njohë rrethanat që kushtëzojnë përdorimin e njërës apo tjetrës.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën di, dua të di, mësova;
- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- identifikojnë gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare;
- në grupe punojnë detyrat;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim – Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (di, dua të di mësova)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Dialekti	Për gjuhën standarde dhe gjuhën zyrtare.	Për dialektet e gjuhës shqipe.	Mësova për dialektin e gegërishtes dhe të toskërishtes.

Pjesën mësova e plotësojnë në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi – Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Mësimdhënësi shkruan në tabelë disa fjalë në dialekt dhe u kërkon nxënësve t'i kthejnë në gjuhën standarde.


Hapi i dytë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Dialekti".

U kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes fragmentin që përshkruan një dhomë miqsh dhe të shënojnë fjalë e trajta fjalësh që u duken se dallojnë prej formave të standardit.

Shpjegon se:

Dialekti është një variant i gjuhës, i cili përdoret si mjet komunikimi për një bashkësi njerëzish pak a shumë të vogël, të cilët jetojnë në zona të caktuara gjeografike. Një gjuhë mund të ketë disa dialekte. Gjuha shqipe ka dy dialekte:



Gegërishtja është dialekti që flitet në pjesën veriore të Shqipërisë, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoninë e Veriut dhe në Serbi.

Toskërishtja është dialekt që flitet në jug të Shqipërisë, në një pjesë të vogël të Maqedonisë, Greqi dhe në Italinë Jugore nga arbëreshët.

E folmja është një njësi edhe më e vogël, që përfaqëson gjuhën apo dialektin e përdorur nga njerëzit në një zonë më të vogël gjeografike se dialekti, p.sh.: e folmja e Shkodrës, e Pukës, e Nikaj-Mërturit, e Lumës, e Mirditës etj.

Nxënësit dëgjojnë me kujdes shpjegimin e mësimdhënësit.

Reflektim – Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren shkollore u përgjigjet pyetjeve:

1. Ç'është dialekti?
2. Cilat janë dallimet e dialektit me gjuhën standarde?
3. Cilat janë dialektet e gjuhës shqipe?
4. Ç'është e folmja?

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme.

Plotësojnë pjesën e *tabelës mësova*.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për dialektet.

Detyrë shtëpie: Gjeni një tekst të shkruar në dialekt dhe një tekst të shkruar në gjuhën standarde. Tregoni dallimet midis tyre.

Planifikimi ditor 3

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Dialekti.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe: gegërisht, toskërisht.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të njohë rolin dhe pozitën e gjuhës amtare dhe të orientohet në mjedisin gjuhësor.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

të dallojë gjuhën standarde shqipe dhe varietetet jostandarde (në dialekt), si dhe të njohë rrethanat që kushtëzojnë përdorimin e njërës apo tjetrës.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe fton disa nxënës t'i lexojnë. Komentojnë rreth përgjigjeve të nxënësve.

I pyet nxënësit se çfarë dinë për dialektin.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Realizim kuptimi -Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Mësimdhënësi lexon ushtrimin 1 dhe i orienton nxënësit për të punuar në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë ushtrimin 1 në fletoren e punës.

Fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin 2 dhe 3 nën a,b dhe c sipas kërkesave.

Plotësojnë ushtrimin 2 dhe 3 nën a,b dhe c sipas kërkesave.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Hapi i dytë

Mësimdhënësi ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe jep udhëzime sipas kërkesave.

- **Grupi I** - Shkruani tri fjali në dialekt dhe i ktheni në gjuhën standarde.
- **Grupi II** - Shkruani tri fjali në dialekt dhe i ktheni në gjuhën standarde.
- **Grupi III** - Shkruani 10 fjalë në dialekt dhe i ktheni në gjuhën standarde;
- **Grupi IV** - Shkruani 3 fjali në dialekt dhe i ktheni në gjuhën standarde;

Përfaqësuesit e grupit lexojnë përgjigjet.

Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve, dhe kur është e nevojshme, jep sqarime.

Plotësojnë detyrat në fletoren e punës dhe i lexojnë.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, stuhi mendimesh)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të punojnë detyrën 6 sipas kërkesës në fletoren e punës.

Nxënësit punojnë detyrën 6 sipas kërkesës në fletoren e punës dhe lexojnë punimet e veta.

Hapi i dytë

Dëgjon me kujdes punimet e nxënësve.

Detyrë shtëpie: Shkruani 5 fjali në dialekt dhe i ktheni në gjuhën standarde.

Planifikimi ditor 1 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Struktura e fjalës (Tema dhe mbaresa).

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe:

temë,

mbaresë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mëimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët përbërëse të fjalës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- strukturën e fjalës,
- temën dhe mbaresën.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën INSERT;
- lexojnë me kujdes tekstin dhe sqarojnë domethënien e fjalëve me shkronja të pjerrëta;
- tregojnë çfarë është mbaresa dhe tema;
- në grupe punojnë detyra, duke ndihmuar njëri-tjetrin;
- me ndihmën e mësuesit punojnë në fletore ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (INSERT)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin, të dallojnë fjalët me shkronja të pjerrëta dhe të shpjegojnë si janë ndërtuar.

Bëhet edhe plotësimi i mëtejshëm i tabelës së INSERTIT.

√	+	-	?
---	---	---	---

Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që di ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.
---	-----------------------------------	--	--

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "*Struktura e fjalës*".


Nxënësit lexojnë fjalitë nga teksti mësimor dhe i analizojnë me kujdes ato.

Shpjegon:

Disa fjalë gjatë përdorimit në fjali pësojnë ndryshime, duke marrë forma të ndryshme.

Ajo pjesë e fjalës që ndryshon gjatë përdorimit në fjali quhet

Pjesa e fjalës që mbetet pasi hiqet mbaresa quhet



Mbaresa përdoret për të formuar trajta të reja të fjalëve. Mbaresë marrin emrat kur lako- hen dhe foljet kur zgjedhohen. Te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës dhe tek ato forma fjalësh që nuk kanë mbaresa, tema përkon me vetë fjalën.

Nxënësit dëgjojnë me kujdes shpjegimin e mësimdhënësit.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Shkruani 4 fjalë dhe dalloni temën;

Grupi II - Shkruani 4 fjalë dhe dalloni mbaresën.

Grupi III - Shkruani 4 fjalë dhe dalloni temën dhe mbaresën.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim – Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës:

Në këtë ushtrim nxënësit i kërkohej të dallojë në fjalët e mëposhtme temën dhe mbaresën: *mospërfillje, zotësinë, bukuritë, bllokimin, mbrojtësit, shkrimtarëve, hyjnore, e madhe, përfundonin, punoja, dritës, lexova, martohen.*

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës:

Nxënësi lexon me kujdes dhe plotëson fjalët me mbaresën e duhur.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës:

Nxënësi lexon tekstin me kujdes dhe (me ndihmën e mësimdhënësit) dallon temën dhe mbaresën të fjalët me shkronja të pjerrëta.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara lidhur me strukturën e fjalës.

Detyrë shtëpie: Shkruani disa fjali dhe dalloni temën e mbaresën në fjalët që i përkasin klasës së fjalëve të ndryshueshme.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Struktura e fjalës (Tema dhe mbaresa)

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: temë, mbaresë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët përbërëse të fjalës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë

- strukturën e fjalës;
- temën dhe mbaresën.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi kontrollon detyrat e shtëpisë dhe i pyet nxënësit lidhur me mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe diskutojnë.

Hapi i dytë

I fton nxënësit të punojnë detyrën 1 dhe 2 sipas kërkesës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrën 3 dhe i fton nxënësit të plotësojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës punojnë detyrën 3 sipas kërkesës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në grupe të barabarta.

Secilit grup i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin për t'ju përgjigjur pyetjeve të shpërndara nga mësimdhënësi.

- **GRUPI I** – Gjeni temën dhe mbaresën e foljes *lajmërojmë* dhe *mbyllet*. I vini ato në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore.
- **GRUPI II** – Gjeni temën dhe mbaresën e foljes *nxitonte* dhe *erdha*. I vini ato në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore.
- **GRUPI III** - Gjeni temën dhe mbaresën e foljes *drodha/dridhej* dhe *dola*. I vini ato në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore.
- **GRUPI IV** - Gjeni temën dhe mbaresën e foljes *shtronin*, *pashë* dhe *punova*. I vini ato në vetën e parë njëjës të kohës së tashme të mënyrës dëftore.

Nxënësit prezantojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë fletoren e punës.

Mësimdhënësi dëgjon përgjigjet e grupeve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin 5 dhe 6 në fletoren e punës sipas kërkesave.

Në fletoren e punës nxënësit plotësojnë ushtrimin 5 dhe 6 sipas kërkesave:

Gjeni temën dhe mbaresën në emrat e mëposhtëm.

djalë, vajza, kodër, punëtorë, motra, miq, shkollë, desh, malesh, goglat.

I vini ato në rasën emërore, numri njëjës, trajta e pashquar. Çfarë vini re?

Në tekstin e dhënë në fletorën e punës plotësoni fjalët, duke u vendosur mbaresën e duhur.

Hapi i dytë

Nxënësi lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon nxënësit për shpjegimet që kanë bërë.

Detyrë shtëpie: Shkruani disa fjali dhe dalloni temën e mbaresën në fjalët që i përkasin klasës së fjalëve të ndryshueshme.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përbërësit e fjalës.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit.

Fjalët kyçe:

rrënja,

parashtesa,

prapashtesa.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimin nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët përbërëse të fjalës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimin nxënësi do të jetë në gjendje të njohë

- përbërësit e fjalës,
- rrënjën, parashtesën e prapashtesën.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- identifikojnë përbërësit e fjalës;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna dhe i prezantojnë ato;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;

Organizimi i orës së mësimin

Evokim – Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes fragmentin nga libri i nxënësit dhe të dallojnë fjalët me shkronja të pjerrëta që mund të zbërthehen në përbërës, duke i emërtuar ato sipas përcaktimeve të mëposhtme: *rrënjë, parashtesë, prapashtesë*.


Realizim kuptimi – Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "*Përbërësit e fjalës*".

Hapi i dytë (pema e mendimit)

Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit punojnë pemën e mendimit.



Nxënësit dëgjojnë me kujdes shpjegimin e mësimdhënësit dhe bëjnë pyetje sipas nevojës.

Hapi i tretë (punë në grupe, stuhi mendimesh)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I** – Gjeni rrënjën në fjalët e mëposhtme: *punëtor, anëtar, përhap, zverdh, turpëro.*
- **Grupi II**– Gjeni rrënjën në fjalët e mëposhtme: *shumëzo, trimëri, përkujto, shndrit, trimërisht.*
- **Grupi III** – Formoni familje fjalësh me fjalën **dorë**.
- **Grupi IV**-Formoni familje fjalësh me fjalën **rini**.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i shikojnë së bashku. Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Reflektim – Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së këtij ushtrimi nxënësi u shton parashtesat fjalëve të dhëna. Thoni ç'kuptime marrin fjalët e reja:

punoj, hyj, mbledh, i ditur, besim, lodhje, vesh, kuq, thur, ndërtoj, hap.

Punohet ushtrimi 2 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së këtij ushtrimi nxënësi u shton parashtesat fjalëve të dhëna. Thoni ç'kuptime marrin fjalët e reja:

udhë, kufi, mal, copë, trim, mbjell, njoh, sulmo, mendo, liri, larg.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësi plotëson tabelën e dhënë.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për përbërësit e fjalës.

Detyrë shtëpie: Formoni familje fjalësh me fjalë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Struktura e fjalës (Tema dhe mbaresa)

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: temë, mbaresë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët përbërëse të fjalës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- strukturën e fjalës;
- temën dhe mbaresën.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi u ndan nxënësve një listë me pyetje për përbërësit e fjalës.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Hapi i dytë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrën 3 dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës punojnë detyrën 3 sipas kërkesës: Dalloni parashtesat dhe prapashtesat tek fjalët me shkronja të pjerrëta në tekstin e dhënë.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Kontrollon punën e nxënësve.

Hapi i dytë

Lexon ushtrimin 4 dhe i ndan nxënësit në dy grupe.

Secilit grup i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin për t'ju përgjigjur pyetjeve të shpërndara nga mësim-dhënësi.

- **GRUPI I** - Formoni familje fjalësh me fjalën **vend**;
- **GRUPI II** - Formoni familje fjalësh me fjalën **punë**.

Nxënësit prezantojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë fletoren e punës në vazhdim sipas kërkesave: Gjeni pjesët përbërëse të fjalëve të mëposhtme dhe i vendosni ato në tabelë:

përmbledhjen, këmbësorët, lumturisht, çarmatosjen, mbingarkesën, zbardhjen, stërmundojnë, lirisht. Gjeni temën fjalëformuese të fjalëve të mësipërme.

Lexojnë detyrat e punuara.

Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Në bashkëbisedim me nxënësit nxirren përfundimet.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës sipas kërkesës:

Gjeni 10-12 fjalë të prejardhura. I përdorni ato në një përshkrim të shkurtër (me rreth 9-10 fjali) të bukuri natyrore të zonës suaj. Dalloni rrënjën e këtyre fjalëve.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve, kontrollon dhe vlerëson.

Detyrë shtëpie : Përshkruani klasën tuaj duke përdorur fjalë të prejardhura.

Planifikimi ditor 3

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Fjalë të parme dhe jo të parme.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit.

Fjalët kyçe: fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe emërtojë fjalët e parme dhe fjalët jo të parme.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë

- fjalët e parme dhe jo të parme;
- fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura.

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- lexojnë me kujdes tekstin, duke dalluar fjalët e parme dhe ato që janë formuar prej fjalësh tjera;
- në grupe punojnë detyrat e dhëna dhe i prezantojnë ato;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

I fton nxënësit të lexojnë tekstin nga teksti mësimor dhe të dallojnë cilat fjalë janë të parme e cilat janë të formuara prej fjalësh të tjera.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Fjalët e parme dhe jo të parme".

Thekson se:

Fjalë të parme

janë ato fjalë që nuk janë formuar prej fjalësh të tjera.

Fjalë të parme

janë ato fjalë që janë të formuara prej fjalësh të tjera, me anë të parashtesave ose prapashtesave edhe me mënyra të tjera.

Fjalët jo të parme janë :

- **të prejardhura** (*për-hap, stër-nip, mbret-ëro, ndërt-im* etj.),
- **të përbëra** (*at-dhe, krye-qytet, hekur-udhë* etj.),
- **të përngjitura** (*domethënë, cilido, gjithmonë* etj.).

Hapi i dytë (punë në grupe)


Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I - Ushtrimi 4 nga teksti mësimor**
- **Grupi II - Ushtrimi 4 nga teksti mësimor**
- **Grupi III - Ushtrimi 4 nga teksti mësimor**
- **Grupi IV - Ushtrimi 4 nga teksti mësimor**

Gjeni nga tri fjalë për çdo tip formimi dhe formoni fjali.

Përfaqësuesit grupit lexojnë detyrat e punuara.

Hapi i tretë (pema e mendimit)



Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me ndihmën e mësimdhënësit.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së këtij ushtrimi, në tekstin e dhënë nxënësi dallon fjalët e parme e jo të parme

dhe tregon ndryshimin midis tyre.

Punohet ushtrimi 2 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së këtij ushtrimi, në tekstin e dhënë nxënësi tregon tipin e formimit të fjalëve të dhëna.

Punohet ushtrimi 3 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së këtij ushtrimi, nxënësi gjen temën fjalëformuese të fjalëve të dhëna në librin e nxënësit.

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara lidhur me fjalët e parme dhe jo të parme.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 5 nga teksti mësimor.

Planifikimi ditor 3

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Fjalë të parme dhe jo të parme.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë fjalët e parme dhe fjalët jo të parme.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë

- fjalët e parme dhe jo të parme;
- fjalët e prejardhura, të përbëra dhe të përngjitura

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për fjalët e parme dhe jo të parme.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Hapi i dytë (punë individuale)

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrat në vazhdim dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës punojnë detyrat sipas kërkesave:

Tregoni si janë formuar fjalët e mëposhtme: *lirim, përshëndetje, i palarë, punëmbarë, kalimthi, ndajfolje, shfrytëzoj, atdhe, cilido, i liruar, letërkëmbim, rindërtim, kurrfarë.*

Gjeni temën fjalëformuese të fjalëve: *punoj, kombëtar, largim, zemërngushtë, fshatarësi,*

përpunoj, zmadhoj, i harruar.

Gjeni nga tri fjalë për çdo tip formimi dhe formoni fjali.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Në bashkëbisedim me nxënësit nxirren përfundimet.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe të barabarta.

Secilit grup i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin për t'ju përgjigjur pyetjeve të shpërndara nga mësimdhënësi.

- **GRUPI I – Analizoni fjalët e mëposhtme:** *shndritnin, përbëja.*
- **GRUPI II - Analizoni fjalët e mëposhtme:** *festimeve, i papërtueshëm, udhëtimeve, shpresëdhënës.*
- **GRUPI III - Analizoni fjalët e mëposhtme:** *shndritnin, përbëja, përbuzje.*

Hapi i tretë

Nxënësit prezantojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Në bashkëbisedim me nxënësit nxirren përfundimet.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës.

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës sipas kërkesës:

Shpjegoni si janë formuar fjalët e mëposhtme. Tregoni se cilës klasë fjalësh i përkasin:

posa, kushdo, megjithëse, asnjë, askush, nëse, asnjëherë, përherë, tekdo, gjithmonë.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon me kujdes nxënësit dhe jep sqarime sipas nevojës.

Gjatë gjithë kohës mësimdhënësi nxit dhe aktivizon nxënësit.

Kontrollon dhe vlerëson nxënësit.

Detyrë shtëpie: Përshkruani klasën tuaj duke përdorur fjalë të përbëra dhe tregoni si janë formuar ato.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Telefoni.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, teknika RAFT, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: komunikim, histori.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- sqarojnë domethënien e fjalës telefon;
- aftësohen të kuptojnë historinë e telefonit;
- punojnë me teknikën RAFT;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi fton nxënësit të përgjigjen pyetjeve.

Çfarë kuptoni me termin komunikim? Ku komunikojmë? Si komunikojmë? Cili është mjete më i rëndësishëm i komunikimit?

Nxënësit përgjigjen pyetjeve.


Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Telefoni"

Shpjegon: Një nga mjetet e rëndësishme të komunikimit midis njerëzve është edhe telefoni.

Me ndihmën e tij dy persona komunikojnë me njëri-tjetrin për probleme të jetës së përditshme.



të tij komunikimi mund të realizohet jo vetëm me të dëgjuar, por edhe duke u parë, si dhe përmes dërgimit të mesazheve.

Lexojnë të dhënat për historinë e telefonit dhe të celularit nga libri i nxënësit.

Hapi i dytë (teknika RAFT)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta, ku secilit grup i kërkohet të shkruajë një temë për telefonin dhe mënyrën e përdorimit të tij.

- **Grupi I - Rëndësia e celularit.**
- **Grupi II - Përparësitë e përdorimit të celularit.**
- **Grupi III - Anët negative të përdorimit të celularit.**

Hapi i tretë (bashkëbisedim)

Pasi mbarojnë ushtrimin e tyre, nxënësit këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Ushtrime:

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, duke iu përgjigjur pyetjeve:

1. Cila është historia e zbulimit të tij?
2. Fol për telefonin e parë.
3. Cilat janë përparësitë e bisedës me telefon?
4. Kur u bë kalimi nga telefoni në celular?

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për telefonin.

Detyrë shtëpie: Shkruani për shpikjen e telefonit.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Telefoni.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: komunikim, histori.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin e fundit dhe paraqet pyetjet e përgatitura në power point.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të paraqitura nga mësuesi në power point.

Hapi i dytë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Nxënësit përqendrojnë vëmendjen rreth këtyre detyrave.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrën 3 dhe 4 dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës punojnë detyrën 3 dhe 4 sipas kërkesës:

Kush ishte Aleksandër Graham Bell?

Pse përdoren satelitët?

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe të barabarta.

Secilit grup i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin për t'ju përgjigjur pyetjeve të shpërndara nga mësim-dhënësi.

- **GRUPI I** – Anët pozitive të celularit
- **GRUPI II** - Anët negative të celularit.
- **GRUPI III** - **Anët negative dhe pozitive të celularit.**

Hapi i tretë

Nxënësit prezantojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës sipas kërkesave.

Nxënësit diskutojnë për saktësinë e përgjigjeve.

Mësimdhënësi dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Po ashtu i drejton nxënësit në diskutim gjatë dhënies së përgjigjeve.

Reflektim -Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës sipas kërkesave:

Kush ishte shpikësi i celularit?

Sa peshonte celulari i tij?

Cili ishte propozimi i Fil Marso?

Hapi i dytë

Lexojnë detyrat e punuara.

I aktivizon të gjithë nxënësit.

Vlerëson nxënësit për detyrat e punuara.

Detyrë shtëpie: Përshkruani celularin tuaj.

Planifikimi ditor 2 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Biseda telefonike.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çift.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: komunikim, telefon, bisedë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë bisedën telefonike;
- punojnë detyrat e dhëna në çift;
- në fletoren e punës punojnë ushtrime nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

Realizon lidhjen e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Mësimdhënësi i pyet nxënësit lidhur me telefonin dhe mënyrën përdorimit të tij.

Hapi i dytë (di, dua të di, mësova)

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Biseda telefonike	Për mënyrën e komunikimit.	Çfarë është biseda telefonike?	Mësova të dhënat bazë rreth bisedës telefonike.

Pjesën mësova e plotësojnë në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë *"Biseda telefonike"*.

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes tekstin nga libri i nxënësit për bisedën telefonike, duke dhënë shpjegime shtesë.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale, punë në çifte)

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit në çifte dhe në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Përse shërben telefoni?
2. Çfarë është biseda telefonike?
3. Si realizohet një bisedë telefonike?
4. Cilat janë disa nga elementet përbërëse të bisedës telefonike?

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për bisedën telefonike.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë telefonike.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Biseda telefonike

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në çifte.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: komunikim, telefon, bisedë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin e fundit dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Hapi i dytë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Nxënësit përqendrojnë vëmendjen rreth këtyre detyrave.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në çifte, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Mësimdhënësi lexon me kujdes detyrën 3 dhe 4 dhe i fton nxënësit të punojnë.

Në fletoren e punës nxënësit punojnë detyrën 3 dhe 4 sipas kërkesave:

Çfarë kemi në përdorim ditët e sotme?

Si zhvillohet një bisedë telefonike?

Nxënësit lexojnë detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Hapi i dytë

Mmësimdhënësi i fton nxënësit në çifte të shkruajnë një bisedë telefonike.
Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin në çifte të shkruajnë një bisedë telefonike.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë në çifte, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Nxënësit në çifte lexojnë bisedat telefonike.

Dëgjon me kujdes nxënësit dhe vlerëson disa biseda telefonike të shkruara më mirë.

Bëjnë diskutime, sqarime.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë telefonike.

Planifikimi ditor 3

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Llojet e bisedave telefonike.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, Diagrami i Venit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: komunikim, telefon, bisedë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- identifikojnë llojet e bisedave telefonike;
- punojnë me metodën Diagrami i Venit, duke u ndihmuar nga mësuesi;
- punojnë detyrat nga teksti mësimor dhe i komentojnë.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Nxënësit përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga mësuesi.

Realizim kuptimi- Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësuesi shkruan titullin në tabelë "Llojet e bisedave telefonike".

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes bisedat telefonike nga libri i nxënësit.

Shpjegon:

Dallojmë dy lloje kryesore bisedash telefonike: *zyrtare* (formale) dhe *private* (joformale).

Biseda zyrtare (formale)


është një bisedë që zhvillohet midis dy personave për çështje pune dhe ka karakter formal.

Biseda jozyrtare (joformale)

është një bisedë telefonike e zhvilluar midis dy të afërmeve, të njohurve apo miqve.

Hapi i dytë (Diagrami i Venit)

Mësimdhënësi vizaton në tabelë Diagramin e Venit duke vërejtur të përbashkëtat dhe dallimet.



Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Çfarë bisedash mund të bëhen në telefon?
2. Ç'është biseda zyrtare (formale)?
3. Cilat janë veçoritë e bisedës zyrtare?
4. Ç'është biseda private (joformale)?
5. Cilat janë veçoritë e bisedës private?
6. Ndërtoni një bisedë telefonike zyrtare.
7. Ndërtoni një bisedë telefonike private.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për bisedën telefonike zyrtare dhe atë private.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë telefonike private.

Planifikimi ditor 3

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Llojet e bisedave telefonike.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, harta e mendjes.

Fjalët kyçe: komunikim, telefon, bisedë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.

Hapi i dytë

Mësimdhënësi fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrën 3 dhe 4 dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës nxënësit punojnë detyrën 3 dhe 4.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Hapi i dytë

Ndan nxënësit në dy grupe të barabarta, duke u caktuar edhe kohën për të shkruar bisedat

telefonike.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin të shkruajnë një bisedë telefonike.

- **Grupi I** - Shkruani një bisedë telefonike zyrtare.
- **Grupi II** - Shkruani një bisedë telefonike private.

Përfaqësuesit e grupit lexojnë bisedat telefonike.


Dëgjon me kujdes bisedat e shkruara telefonike.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(harta e mendjes)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të plotësojnë hartën e mendjes.



Hapi i dytë

Nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit plotësojnë hartën e mendjes.

Detyrë shtëpie: Shkruani një bisedë telefonike.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Klasat e fjalëve.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë klasat e fjalëve.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- klasat e fjalëve;
- fjalët e ndryshueshme (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim) dhe ato të pandryshueshme.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me metodën INSERT;
- sqarojnë domethënien e fjalëve me shkronja të pjerrëta;
- dallojnë fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme;
- në grupe punojnë detyrat;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (INSERT)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes përshkrimin dhe të dallojnë fjalët e ndryshueshme dhe ato të pandryshueshme.

Bëhet edhe plotësimi i mëtejshëm i tabelës së INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që di ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Klasat e fjalëve".


Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë pjesën nga libri i nxënësit dhe të dallojnë fjalët

me shkronja të zeza dhe ato me shkronja të pjerrëta.

Thekson se fjalët që ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali, quhen **fjalë të ndryshueshme** apo pjesë të ndryshueshme të ligjëratës.

Fjalët që dalin me një formë të vetme dhe që nuk mund të ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali, quhen fjalë të pandryshueshme ose pjesë të pandryshueshme të ligjëratës.

Nxënësit vështrojnë tabelën e paraqitur te libri i nxënësit.



Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet shkruajnë një ese dhe nënvizojnë me një vijë fjalët e ndryshueshme dhe me dy vija fjalët e pandryshueshme.

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime. Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim – Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit nxënësi nënvizon me të kuqe fjalët e ndryshueshme dhe me blu fjalët e pandryshueshme.

Punohet ushtrimi 2 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit nxënësi lexon me kujdes detyrën dhe i ndan fjalët në të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Punohet ushtrimi 3 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit nxënësi plotëson tekstin me fjalët që mungojnë.

Punohet ushtrimi 4 nga teksti mësimor:

Nxënësi formon fjali me fjalët: *bari, rrugë, por, përëndo, nga, fsheh, sipër, kur, i madh, qiell*.

Punohet ushtrimi 5 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit nxënësi në tabelën majtas sipas klasave shënon disa fjalë të ndryshueshme dhe në tabelën djathtas disa fjalë të pandryshueshme.

Punohet ushtrimi 6 nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësi lidh me një vijë fjalën me klasën në të cilën bën pjesë.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara për klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Detyrë shtëpie: Të punohet me kujdes ushtrimi i fundit.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Klasat e fjalëve.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, teknika e kubimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mëimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë klasat e fjalëve.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- klasat e fjalëve;
- fjalët e ndryshueshme (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim) dhe ato të pandryshueshme.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin e fundit dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

Hapi i dytë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe e plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Mësimdhënësi lexon me kujdes detyrën 3 dhe i fton nxënësit të punojnë.

Në fletoren e punës nxënësit punojnë detyrën 3 sipas kërkesës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në katër grupe dhe shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Nxënësit ndihmojnë njëri-tjetrin t'u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi.

- **GRUPI I** – punon ushtrimin 4 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI II** – punon ushtrimin 5 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI III** - punon ushtrimin 6 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI IV** - punon ushtrimin 7 nga fletorja e punës sipas kërkesës;

Nxënësit prezantojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës sipas kërkesave përkatëse.

Ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve, si dhe punën në grupe.

Hapi i tretë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Nxënësit punojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës sipas kërkesës:


Bëni një përshkrim të shkurtër me temën *“Një fundjavë me shokët e shoqet e klasës në fshatin Traboin të Malësisë”*, duke përdorur fjalë të klasave të ndryshme.

Nxënësit lexojnë detyrën dhe e komentojnë me mësimdhënësin.

Reflektim- Pjesa përfundimtare e orës

(teknika e kubimit, bashkëbisedim)

Hapi i parë



Mësimdhënësi paraqet detyrën.

Mësimdhënësi në të gjitha faqet e kubit shkruan një kërkesë dhe nxit nxënësit të përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet për secilën faqe të kubit.

Detyrë shtëpie: Shkruani tri fjali dhe i ndani fjalët sipas klasave.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Emri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: emrat e përgjithshëm e të përveçëm, konkretë, abstraktë, përmbledhës e të lëndës.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- emrat (konkretë, abstraktë).

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikë stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- lexojnë me kujdes tekstin e dhënë, duke dalluar emrat, si dhe duke sqaruar se çfarë tregojnë ata;
- aftësohen të dallojnë emrin;
- kujtojnë njohuritë e mëparshme përmes pemës së mendimit;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të paraqitura nga mësuesi.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësuesi shkruan titullin në tabelë "Emri".

Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin dhe të dallojnë emrat, si dhe çfarë tregojnë ata. Thekson se **emri** është ajo klasë fjalësh që emërtim qenie të gjalla, sende, dukuri të natyrës, veprime, tipare, nocione abstrakte, duke dhënë shembuj konkretë.

Sipas kuptimit emrat ndahen në dy grupe të mëdha:

emra të përgjithshëm

emra të përveçëm.

Emra të përgjithshëm janë

ato fjalë që emërtojnë në mënyrë të përgjithshme frymorë apo sende të së njëjtës klasë (*djalë, pemë, fushë, ajër, ditë, mendim* etj.).

Emra të përveçëm janë

ato fjalë që emërtojnë frymorë ose sende të dalluara nga frymorët ose sendet e së njëjtës klasë (*Agim, Kuqo, Adratik, Shkumbin, Tarabosh, Ulqin, Tuz* etj.).

Emrat e përgjithshëm ndahen në

emra **konkretë**

(*njeri, vajzë, libër, qytet, zhurmë* etj.)

emra **abstraktë**

(*mirësi, besim, durim, dyshim* etj.)

përmbledhës


(*popullsi, rini, djalëri* etj.)

lëndorë

(*djathë, gjalpë, kos, mjaltë, verë, raki, grurë* etj.)

Hapi i dytë (pema e mendimit)

Kujtojmë gjininë dhe numrin e emrit përmes pemës së mendimit.



Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit nxënësi dallon emrat që shënojnë frymorë, sende dhe dukuri, duke i vendosur në tabelë.

Punohet ushtrimi 2 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës nxënësi në tekstin e dhënë të libri i nxënësit i plotëson vendet e lëna bosh me emra të përveçëm.

Punohet ushtrimi 3 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës nxënësi dallon emrat në tekst dhe i vendos në tabelën e dhënë.

Punohet ushtrimi 4 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës nxënësi ndërton fjali me 5 emra të përveçëm dhe të përgjithshëm.

Punohet ushtrimi 5 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës nxënësi nënvizon me një vijë emrat përmbledhës dhe më dy vija emrat lëndorë. Shpjegon ndryshimet midis tyre.

Punohet ushtrimi 6 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës nxënësi gjen emrat dhe dallon numrin e gjininë e tyre.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara për emrin.

Detyrë shtëpie: Bëni një përshkrim të qytetit tuaj, duke përdorur sa më shumë emra të përveçëm.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Emri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, harta e mendjes.

Fjalët kyçe: emrat e përgjithshëm e të përveçëm, konkretë, abstraktë, përmbledhës e të lëndës.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- emrat (konkretë, abstraktë).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë në fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2 e 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 e 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës kërkesat përkatëse.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Lexon me kujdes detyrën 4 e 5 dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë detyrat sipas kërkesave dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në katër grupe të barabarta dhe i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Ushtrimi 5 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI II** – Ushtrimi 6 nga fletorja e punës sipas kërkesës;

- **GRUPI III** – Ushtrimi 5 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI IV** – Ushtrimi 6 nga fletorja e punës sipas kërkesës;


Nxënësit duke ndihmuar njëri-tjetrin u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi.

Diskutojnë në grupe rreth detyrave të dhëna. Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(hartë e mendjes)

Vizaton hartën e mendjes dhe fton nxënësit të plotësojnë.



Nxënësit plotësojnë hartën e mendjes me ndihmën e mësimdhënësit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni emrat.

Planifikimi ditor 2 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lakimi i emrit.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: rasë lakim.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- lakimin e emrave;

rasat (emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore) dhe domethënien e tyre.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën INSERT;
- aftësohen të dallojnë rasat e emrit;
- përmes rrjetit të diskutimit kujtojnë njohuritë e mëparshme për lakimin e emrit;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (INSERT)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë me kujdes tekstin nga teksti mësimor. U kërkon të gjejnë emrat dhe të dallojnë në cilën rasë janë përdorur, si dhe të provojnë t'i lakojnë.

Bëhet edhe plotësimi i mëtejshëm i tabelës së INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që di ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi – Pjesa kryesore e orës


Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "*Lakimi i emrit*"

Thekson se format e ndryshme që merr emri duke u lidhur me fjalë të tjera në fjali, quhen rasa.


Nxënësit lexojnë me kujdes shembujt nga libri i nxënësit.

Shpjegon:

Rasat e emrit janë:  emërore > gjinore > dhanore > kallëzore > rrjedhore

Hapi i dytë (rrjeti i diskutimit)

Kujtoni:

Trajtat e emrit:  e pashquar (*Një **shitës gazetash** vinte vërdallë.*)
e shquar (***Zogu** fluturoi drejt pemëve aty pranë.*)

Tërësia e ndryshimeve që pëson emri, kur përdoret në rasa të ndryshme, quhet **lakim**.

Mbështetur në mbaresat e rasës emërore të trajtës së shquar, emrat mund të klasifikohen në katër lakime:

- lakimi i parë (*nxënësi, qyteti, fshati, pallati, libri* etj.);
- lakimi i dytë (*miku, fiku, plaku, zogu* etj.);
- lakimi i tretë (*nëna, motra, shoqja, lulja, letra* etj.);
- lakimi i katërt (*të punuarit, të mësuarit, të nxënësit, të ftohtët* etj.).

Vështrojnë tabelën nga libri i nxënësit dhe diskutojnë për lakimin e emrit.

Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Lakoni në trajtën e shquar dhe të pashquar, në të dy numrat, emrat:

- **Grupi I** - qiell,
- **Grupi II** - mik,
- **Grupi III** - gojë,
- **Grupi IV** - vajzë,
- **Grupi V** – libër.

Mësimdhënësi ndjek punën e grupeve dhe jep sqarime, kur është e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në çifte dhe në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit u kërkohet nxënësve të formojnë 5 fjali, ku emrat ***nxënës*** dhe ***mësuese*** në numrin njëjës, trajta e shquar, të përdoren në të gjitha rasat.

Punohet ushtrimi 2 sipas tekstit mësimor:

Nxënësit lidhin me një vijë emrin me rasën në të cilën ai është.

Punohet ushtrimi 3 nga teksti mësimor:

Sipas kërkesës së ushtrimit u kërkohet nxënësve të dallojnë rasën dhe lakimin e emrave.

Punohet ushtrimi 4 nga teksti mësimor:

Nxënësit gjejnë emrat dhe bëjnë analizën e plotë morfologjike të tyre.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për lakimin e emrit.

Detyrë shtëpie: Formoni fjali me emrin ***shkollë*** dhe ***shtëpi***, duke i përdorur në rase të ndryshme.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lakimi i emrit.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, harta e mendjes.

Fjalët kyçe: rasë lakim

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- lakimin e emrit

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës-nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1,2 dhe 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 dhe 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë detyrat sipas kërkesave dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në katër grupe të barabarta dhe i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Ushtrimi 4 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI II** – Ushtrimi 5 nga fletorja e punës sipas kërkesës;
- **GRUPI III** – Ushtrimi 7 nga fletorja e punës sipas kërkesës;

Nxënësit duke ndihmuar njëri-tjetrin u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi.

si.

Përfaqësuesi i grupit jep sqarime më të hollësishme.

Diskutojnë në grupe rreth detyrave të dhëna. Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Fton nxënësit punojnë ushtrimin 6 sipas kërkesës:

Përshkruani një ditë me reshje shiu në qytetin/fshatin tuaj, duke përdorur sa më shumë emra. Pranë çdo emri shënoni lakimin.


Nxënësit punojnë ushtrimin në fletoren e punës.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(harta e mendjes)

Hapi i parë

Që të vërtetohen arritjet e nxënësve i fton të plotësojnë hartën e mendjes.



Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë hartën e mendjes me ndihmën e mësimitdhënësit.

Të gjithë nxënësit aktivizohen.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni emrat.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Reklama.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: reklamë, reklamim.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

të dëgjojë tekste të shkurtra joletrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara (reklammat e radios/TV-së).

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- shikojnë materialin e paraqitur me videoprojektor;
- dallojnë llojet e reklamave;
- punojnë në grupe detyrat e dhëna;
- dëgjojnë biseda të incizuara dhe vetë përgatisin të ngjashme;
- punojnë në fletoren e punës ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Paraqitje e materialit me videoprojektor.

Nxënësit përgjigjen pyetjeve të përgatitura lidhur me materialin e dhënë.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Reklama"

Mësimdhënësi thekson se **reklama** është çfarëdo shpalljeje publike, e cila rekomandon dhe thekson cilësitë e mira të një prodhimi apo shërbimi, shtyn përpara ndonjë ide apo çështje, me qëllim që t'i bëjë tërheqëse për konsumatorët e mundshëm.



Mësimdhënësi thekson se kemi disa lloje reklamash, si:

1. reklamat e medias së shkruar,
2. reklamat televizive,
3. reklamat e radios,
4. reklamat online,
5. reklamat e jashtme,
6. reklamat e ndërgjegjësimit,
7. reklamat institucionale,
8. reklamat e fshehta.

Hapi i dytë (rrjeti i diskutimit)

Nxënësit diskutojnë me mësimdhënësin për llojet e reklamave.

Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Secili grup shkruan një reklamë sipas dëshirës.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë(punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve nga libri i nxënësit.

Nxënësi në fletoren shkollore u përgjigjet pyetjeve:

1. Ç'është reklama?
2. Përse shërben ajo?
3. Cilat janë objektivat kryesorë të reklamës?
4. Cilat janë llojet kryesore të reklamave?
5. Jepni shembuj reklamash të ndryshme sipas llojeve.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin. Bëjnë plotësime, sqarime rreth pyetjeve.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për reklamën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Reklama.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: reklamë, reklamim.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste jolettrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë tekste të shkurtra jolettrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara (reklamat e radios/TV-së).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin fundit dhe paraqet pyetjet me videoprojektor.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të paraqitura me videoprojektor.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 3 e 4 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 3 e 4 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në tri grupe të barabarta dhe i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani një reklamë që e keni parë në televizor.

- **GRUPI II** – Shkruani një reklamë që e keni lexuar;
- **GRUPI III** – Shkruani një reklamë sipas dëshirës;

Nxënësit duke ndihmuar njëri-tjetrit u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi.

Hapi i dytë

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara. Diskutojnë në grupe rreth detyrave të dhëna.

Mësimdhënësi ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve, si dhe punën në grupe.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I orienton nxënësit të plotësojnë ushtrimin në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë ushtrimin e fundit në fletorën e punës sipas kërkesës: Shkruani një reklamë duke promovuar disa ushqime tradicionale;

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë reklamat e shkruara dhe i komentojnë.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Karakteristikat e reklamës.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: reklama, kreativiteti, qartësia, tërheqja, emocionaliteti, rrjedha logjike, kohëzgjatja.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

të dëgjojë tekste të shkurtra joletrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara (reklamën e radios/TV-së).

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- u përgjigjen pyetjeve të paraqitura me videoprojektor;
- dëgjojnë biseda të incizuara dhe vetë përgatisin të ngjashme;
- lexojnë me kujdes tekstin nga libri i nxënësit;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- punojnë detyrat e dhëna në grupe;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Shikim i materialit të paraqitur me videoprojektor.

Diskutojnë rreth materialit të shikuar.


Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Karakteristikat dhe elementet e reklamës".


Nxënësit punojnë me tekstin mësimor.

Thekson se një reklamë duhet të karakterizohet nga disa tipare themelore, si:



Hapi i dytë (pema e mendimit)

Punojnë me metodën pema e mendimit, duke e plotësuar në tabelën me ndihmën e më simdhënësit.



Mësuesi jep sqarime të hollësishme se si duhet të punohet një reklamë.

Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe ju shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse.

Përgatitni një reklamë, ku të promovoni:

- **Grupi I** - disa nga prodhimet bujqësore të zonës suaj.
- **Grupi II** - turizmin në zonat bregdetare.
- **Grupi III** - turizmin në zonat malore.

Lexohen reklamat dhe diskutohen nga vetë nxënësit. Nëse ka pyetje, jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Cili është funksioni i reklamës?
2. Çfarë duhet të kemi parasysh kur bëjmë një reklamë?
3. Cilat janë tiparet themelore të reklamës?
4. Cilat janë elementet e reklamës?
5. Si duhet të jetë mesazhi që përcjell reklama?
6. Si duhet të jetë slogani që përmban reklama?
7. Cili është roli i logos?
8. Cilat janë hapat që ndiqen për krijimin e një reklame?
9. Çfarë duhet të përmbajë mesazhi i reklamës?

10. Si duhet të jetë përmbajtja e reklamës?

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për karakteristikat e reklamës.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë televizive.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Karakteristikat reklamës.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: reklama, kreativiteti, qartësia, tërheqja, emocionaliteti, rrjedha logjike, kohë-zgjatja.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mëimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë tekste të shkurtra joletrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara (reklamat e radios/TV-së).
- të njohë historinë e reklamës.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe i pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në tri grupe të barabarta dhe i shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I – Shkruani një reklamë, duke promovuar turizmin malor;**
- **GRUPI II – Shkruani një reklamë, duke promovuar turizmin bregdetar;**
- **GRUPI III – Shkruani një reklamë sipas dëshirës.**

Nxënësit duke ndihmuar njëri-tjetrit u përgjigjen pyetjeve të përgatitura nga mësimdhënësi.

Hapi i dytë

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara. Diskutojnë në grupe rreth detyrave të dhëna.

Mësimdhënësi ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve, si dhe punën në grupe.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Nxënësit plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës sipas kërkesës;

Shkruani një reklamë sipas këtyre karakteristikave, ku të promovoni turizmin në komunën tuaj.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë reklamat e shkruara dhe i komentojnë.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 3

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Historia e reklamës.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: reklamim, reklamë, histori.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst:

të dëgjojë tekste të shkurtra joletrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara (reklamat e radios/TV-së).

- të njohë historinë e reklamës.

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- lexojnë me kujdes tekstin për historinë e reklamave;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve.

Mësimdhënësi i pyet nxënësit lidhur me karakteristikat e reklamës.

Hapi i dytë (di, dua të di, mësova)

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Historia e reklamës.	Për karakteristikat e reklamës.	Për historinë e reklamës.	Me ndihmën e mësimit-dhënësit mësova për historinë e reklamës.

Në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "*Historia e reklamës*".

Mësimdhënësi i fton nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin nga teksti mësimor për historinë e reklamës, duke dhënë shpjegime shtesë.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Nxënësi në fletoren e punës u përgjigjet pyetjeve:

1. Ku i gjejmë për herë të parë reklamat?
2. Cila është reklama e parë?
3. Kur lindi shërbimi i reklamimit dhe si u organizua ai?
4. Cilat janë rregullat kryesore të reklamimit sipas traktatit të Daniel Stash?
5. Cilët ishin faktorët që ndikuan në shndërrimin e reklamës në një industri të vërtetë?

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara. Bëjnë plotësime, sqarime rreth kërkesave.

Plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për historinë e reklamës.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë shtypi.

Planifikimi ditor 3 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Historia e reklamës.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, harta e mendjes.

Fjalët kyçe: reklamim, reklamë, histori.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, lexojë, kuptojë, analizojë dhe krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë tekste të shkurtra joletrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë të ekranizuara (reklamat e radios/TV-së).
- të njohë karakteristikat e reklamave.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

I pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2 e 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 e 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Lexon me kujdes detyrat dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesave dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Bëjnë plotësime, sqarime rreth kërkesave.

Hapi i dytë

Nxënësit duke ndihmuar njëri-tjetrin u përgjigjen pyetjeve.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.


I aktivizon të gjithë nxënësit.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(hartë e mendjes)

Hapi i parë

Për të vërtetuar arritjet e nxënësve rreth reklamave mësimdhënësi përmes pyetjeve konkrete drejtuar nxënësve i fton të plotësojnë hartën e mendjes.



Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë hartën e mendjes duke shpalosur mendimet e tyre.

Detyrë shtëpie: Shkruani një reklamë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Mbiemri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: i nyjshëm, i panyjshëm.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë mbiemrat;
- përcaktojnë llojin e mbiemrave;
- punojnë me metodën Di, dua të di, mësova;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Lexoni me kujdes përshkrimin dhe dalloni mbiemrat; thoni me cilët emra formojnë një grup emëror (p.sh. natyra e bukur).

Hapi i dytë (di, dua të di, mësova)

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Mbiemri	Mbiemri cilëson një emër a përemër.	Si klasifikohen mbiemrat?	Mbiemrat janë të nyjshëm dhe të panyjshëm.

Në fund të orës mësimore plotësojnë pjesën e tabelës mësova.


Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)


Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Mbiemri".

Thekson se mbiemër quhet ajo klasë fjalësh që emërton tipare të sendeve apo të frymorëve. P.sh.: djalë **i mirë**, vajzë **e bukur**, burrë **trim**, djalë **besnik** etj.

Mbiemrat në gjuhën shqipe i kemi **dy llojesh**:



Në gjuhën shqipe mbiemrat kanë dy gjini:



Prej formës së gjinisë mashkullore formohet gjinia femërore.

1. Mbiemrat e nyjshëm e formojnë gjininë femërore:

a) duke ndryshuar vetëm nyjën e përpame **i** në **e**, p.sh.:

i mirë – **e** mirë,

i rëndë – **e** rëndë

b) duke ndryshuar nyjën e përpame **i** në **e** dhe duke marrë mbaresën -e, p.sh.:

i djeshëm – **e** djeshme,

i afërm – **e** afërme.

2. Mbiemrat e panyjshëm e formojnë gjininë femërore:

a) duke i shtuar temës së gjinisë mashkullore mbaresën -e:

fizik – fizike,

normal – normale,

b) duke ruajtur të pandryshuar formën e gjinisë mashkullore:

djalë belhollë – vajzë belhollë djalë gojëmjaltë – vajzë gojëmjaltë.

Nxënësit zgjidhin ushtrimet nga teksti mësimor.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I - Me mbiemrin i lirë krijë 4 fjali.**
- **Grupi II - Me mbiemrin bujar krijë 3 fjali.**
- **Grupi III - Me mbiemrin i urtë krijë 4 fjali.**
- **Grupi IV - Me mbiemrin i zoti krijë 3 fjali.**

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përmes këtij ushtrimi nxënësi plotëson tekstin me disa mbiemra që shënojnë cilësi, tipare, ngjyrë, formë, madhësi apo radhë.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni dy fjali me mbiemra të nyjshëm dhe dy me mbiemra të panyjshëm. Çfarë vini re?

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë gjeni mbiemrat dhe thoni në ç'gjini janë ato.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lidhni me një vijë mbiemrin me emrin përkatës duke pasur parasysh gjininë.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara. Bëjnë plotësime, sqarime rreth kërkesave.

Plotësojnë pjesën e tabelës mësova.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për mbiemrin.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese dhe nënvizoni mbiemrat.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Mbiemri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: i nyjshëm, i panyjshëm.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2 e 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 e 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

I orienton nxënësit të punojnë detyrat në fletoren e punës sipas kërkesave. Në fletoren e punës punojnë detyrat sipas kërkesave: Me mbiemrat *i madh, krenar, i zgjuar, trim* formoni fjali, duke i përdorur herë në gjininë mashkullore, herë në gjininë femërore. Grupet emërore i ktheni në gjininë femërore. Tregoni si e formojnë atë. Mbiemrat në kllapa i vini në formën e duhur. Tregoni gjininë e tyre.

Lexon me kujdes detyrat dhe i fton nxënësit të punojnë në fletoren e punës.

Në fletoren e punës nxënësit punojnë detyrat sipas kërkesave.

I aktivizon të gjithë nxënësit.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara.

Ndjek me vëmendje aktivizimin e nxënësve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të punojnë ushtrimin e fundit nga fletorja e punës.

Plotësojnë detyrën në fletorën e punës sipas kërkesës:

Bëni një përshkrim të shkurtër të pushimeve verore të këtij viti, duke përdorur sa më shumë mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm. Dalloni gjininë e tyre.

Hapi i dytë

Lexojnë përshkrimin e pushimeve verore.

Dëgjon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Detyrë shtëpie: Shkruani disa fjali, ku të përdorni sa më shumë mbiemra. I nënvizoni ato.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Numri i mbiemrave.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe: numri njëjës, numri shumës.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë numrin njëjës dhe shumës të mbiemrave;
- punojnë në grupe detyra të ndryshme;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqet dhe komunikon lirshëm dhe saktë mendimin e tij.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Mësimdhënësi i fton nxënësit të lexojnë fragmentin kushtuar punës së një specialisti në trajnimin e futbollistëve të rinj; thoni në cilin numër janë mbiemrat me shkronja të pjerrëta dhe me cilët emra formojnë grupe emërore.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës


Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë " Numri i mbiemrave.

Punojnë me tekstin mësimor.

Shpjegon se:

Mbiemrat në gjuhën shqipe përdoren në dy numra:



Ashtu si në gjini, ai përshtatet edhe në numër me emrin të cilin përcakton, pra, kur emri është në numrin njëjës, edhe mbiemri është në numrin njëjës dhe anasjelltas, kur emri është në numrin shumës, edhe mbiemri është në numrin shumës. P.sh.:

djalë i mirë – djem të mirë, vajzë e bukur - vajza të bukura etj.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I** - Në fjalinë e mëposhtme gjeni mbiemrat dhe tregoni gjininë e numrin e tyre:

I gjatë, i hijshëm, me trup të derdhur prej statue, me sy të zgjuar, që nxirrnin shkëndi-ja ishte pas dëshmimit të njëzëshëm të historianëve të vjetër një engjëll bukurie e madhështie mashkullore.

- **Grupi II** - Në fjalinë e mëposhtme gjeni mbiemrat dhe tregoni gjininë e numrin e tyre:

Bukuria e madhështia trupore ishin një trashëgim në shtëpinë princërore të Kastriotëve.

- **Grupi III** - Në fjalinë e mëposhtme gjeni mbiemrat dhe tregoni gjininë e numrin e tyre: *Kapërceu rrugën kryesore dhe kaloi trotuarin e djathtë të saj.*

- **Grupi IV** - Në fjalinë e mëposhtme gjeni mbiemrat dhe tregoni gjininë e numrin e tyre:

E kritikuan se rrinte në orët e vona të natës. Jemi në vitet e para të shekullit XXI

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Përfaqësuesit e grupeve lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Kthejini në numrin shumës grupet emërore. Shpjegoni si e kanë formuar shumësin mbiemrat.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni fjali me grupet e mëposhtme. Tregoni gjininë dhe numrin e mbiemrave:

burrë plak, djalë trim, nxënës i mirë, artistë të mëdhenj, shokë të mirë, djem punëtorë, lajm i ri, heronj legjendarë.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Rishkruani në fletore tekstin e dhënë, duke i kthyer emrat në numrin shumës (aty ku është e mundur).

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për numrin e mbiemrit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni mbiemrat.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Numri i mbiemrave.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: numri njëjës dhe numri shumës.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës-nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

I pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2 e 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 e 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Bëjnë plotësime, sqarime.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë individuale, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Mësimdhënësi fton nxënësit të plotësojnë detyrat nga fletorja e punës.

Nxënësit vështrojnë me kujdes kërkesat dhe plotësojnë fletoren e punës.

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara. Aktivizon të gjithë nxënësit. Gjatë diskutimit nxënësit nxjerrin përfundime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I orienton nxënësit të punojnë ushtrimet në vazhdim.

Nxënësit plotësojnë ushtrimin e fundit në fletoren e punës sipas kërkesës:

Përkthyeri një peizazh dimri duke përdorur sa më shumë mbiemra.

Hapi i dytë

Lexojnë përshkrimin.

Dëgjon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Së bashku me nxënësit, mësuesi nxjerr përfundimet nga ushtrimet e punuara.

Detyrë shtëpie: Shkruani disa fjali duke përdorur sa më shumë mbiemra.

Planifikimi ditor 3

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lakimi i mbiemrit.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: INSERT, stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe: lakim, pohore, krahasore, sipërore.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Veprimtaria e nxënësve:

- identifikojnë shkallët e mbiemrit;
- punojnë me teknikën INSERT;
- punojnë në grupe detyra të ndryshme;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqet e komunikon lirshëm dhe saktë mendimin e tij.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (INSERT)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Lexoni bukur tekstin dhe dalloni mbiemrat; tregoni me cilët emra formojnë grupe emërore dhe jepni mendime në cilën rasë janë.

Nënvizimet e bëra nga nxënësit në libër hidhen në tabelën e INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që di ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Lakimi i mbiemrit".

Shpjegon:


Një pjesë e mbiemrave përshtaten me emrin që përcaktojnë jo vetëm në numër e në gjini, por edhe në rasë.

Ata lakohen vetëm në bashkëvajtje me emrat.

Mbiemrat e nyjshëm kur lakohen, ndryshojnë vetëm nyjën e përparme.

Lexojnë tabelat e lakimit nga teksti mësimor.

Kujtojmë: Një pjesë e mbiemrave mund ta shprehin cilësinë në tri shkallë:



Nxënësit zgjidhin ushtrimet nga teksti mësimor.

Hapi i dytë (punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse.

- **Grupi I** – Shkruani 3 fjali duke e përdorur mbiemrin në shkallën pohore dhe krahasore.
- **Grupi II** – Lakoni grupin emëror: *lis i lartë*.
- **Grupi III** – Lakoni grupin emëror: *sportiste e shkathët*.
- **Grupi IV** – Lakoni grupin emëror: *punëtor i ri*.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimpldhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni 5 fjali me grupin emëror *gjuhë e lashtë*, duke e përdorur në rasa të ndryshme.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë nënvizoni mbiemrat. Gjeni gjininë, numrin dhe rasën e tyre (kur e kanë).

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e dhëna gjeni mbiemrat dhe thoni në ç'skallë janë.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e dhëna shënoni me një vijë emrat, me dy vija mbiemrat dhe i analizoni ato.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për lakimin e mbiemrit.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese, ku të përdorni sa më shumë mbiemra. I nënvizoni mbiemrat duke treguar në cilën shkallë janë përdorur ata.

Planifikimi ditor 3 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lakimi i mbiemrave.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: lakim, pohore, krahasore, sipërore.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2 e 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2 e 3 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Bëjnë plotësime, sqarime rreth kërkesave të detyrave.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

I ndan nxënësit në tri grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Formoni fjali duke përdorur mbiemrat në shkallë të ndryshme;
- **GRUPI II** – Shkruani 4 fjali duke përdorur mbiemrat në shkallë të ndryshme;
- **GRUPI III** - Shkruani disa fjali duke përdorur mbiemra.

Përfaqësuesit e secilit grup lexojnë mendimet përfundimtare të përfituara gjatë punës së përbashkët në grupe.

Mësimdhënësi kontrollon dhe vlerëson punën e tyre.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I orienton nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës.

Nxënësit plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës sipas kërkesave:

Me mbiemrat *guximtar* dhe *i fortë* formoni fjali, duke i përdorur në shkallë të ndryshme.

Në tekstin e dhënë nënvizoni mbiemrat dhe tregoni llojin, gjininë, numrin, rasën dhe shkallën e tyre (nëse kanë).

Hapi i dytë

Lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon dhe vlerëson punën e nxënësve.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lajmi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, punë individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit.

Fjalët kyçe: informues, shprehës, apelues.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste jolettrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë tekste të shkurtra jolettrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara dhe ato janë: të reja mbi ngjarje të rëndësishme/aktuale.
- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme.

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë lajmin;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- në grupe punojnë detyra të ndryshme;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqesin dhe komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi paraqet disa foto me videoprojektor.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan në tabelë titullin "Lajmi"

Shpjegon:

Karakteristikat e lajmeve


Lajmi është një njoftim i shkurtër që ia japim dikujt me gojë ose me shkrim për një ngjarje të re ose për diçka që ai nuk e di.

Hapi i dytë (pema e mendimit)

- Lajmi ka një strukturë të thjeshtë.
- Aty pasqyrohen ngjarjet relativisht të fundit.
- Lajmet duhet të jenë të shkurtra e të mos kenë përsëritje apo të dhëna të parëndësishme.


Lajmi ndërtohet mbi bazën e disa pyetjeve.

Punojnë me pemën e mendimit.



Nxënësit shohin me kujdes tekstin mësimor.

Mësuesi shpjegon se kemi 3 lloje lajmesh:



Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat.

Secili grup shkruan një lajm.

Nëse ka pyetje, ato diskutohen nga vetë nxënësit dhe, kur është e nevojshme, mësimdhënësi jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

1. Ç'është lajmi dhe përse shërben ai?
2. Cilat janë karakteristikat themelore të lajmeve?
3. Cilat janë pyetjet kyçe që ndihmojnë për të përgatitur një lajm?
4. Cilat janë elementet kryesore të lajmeve?
5. Cilat janë pjesët kryesore përbërëse të lajmit?

6. Përzgjidhni tri lajme nga shtypi i ditës dhe i klasifikoni ato sipas funksionit (informues, bindës apo apelues).

Hapi i dytë

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për lajmin dhe karakteristikat e tij.

Detyrë shtëpie: Krijoni vetë një lajm.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lajmi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, pema e mendimit.

Fjalët kyçe: informues, shprehës, apelues.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste jolettrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje:

- të dëgjojë tekste të shkurtra jolettrare të rëndomta të folura/të lexuara me zë/të ekranizuara dhe ato janë: të reja mbi ngjarje të rëndësishme/aktuale.
- të dëgjojë biseda të incizuara dhe të përgatisë vetë të ngjashme .

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë në fletoren e punës sipas kërkesës.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrën 3 e 4 dhe plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe të barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani një lajm që e keni parë në televizor.

- **GRUPI II** – Shkruani një lajm që e keni lexuar në ndonjë gazetë;
- **GRUPI III**- Shkruani një lajm lidhur me ndonjë aktivitet shkollor.

Përfaqësuesit e secilit grup lexojnë mendimet përfundimtare rreth detyrave të punuara në grupe.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.


Duke ndjekur udhëzimet e mësimit nxënësit punojnë ushtrimet e tjera në fletoren e punës. Bëjnë plotësime, sqarime rreth kërkesave.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(pema e mendimit)

Hapi i parë

Për të vërtetuar arritjet e nxënësve mësimit përmes pyetjeve rreth lajmit fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit.



Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me ndihmën e mësimit.

I aktivizon të gjithë nxënësit.

Vlerëson nxënësit për njohuritë e arritura për lajmin.

Detyrë shtëpie: Shkruani një lajm sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lajmërimi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova,

Fjalët kyçe: formale, joformale.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të njohë:

- lajmërimet zyrtare dhe jozyrtare, shpallje të vogla.

Veprimtaria e nxënësit:

- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- identifikojnë lajmërimin;
- punojnë në grupe detyra të ndryshme;
- punojnë me teknikën rrjeti i diskutimit;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqesin dhe komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (di, dua të di, mësova)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Lajmërimi	Për lajmin	Çka është lajmërimi?	Mësova për lajmërimin formal dhe informal.

Pjesën mësova e plotësojnë në fund të orës mësimore.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Lajmërimi".

Shpjegon se:

Lajmërimi është një shpallje e vogël që shërben për të na informuar në lidhje me ngjarje të ardhshme. Lajmërimet mund të jenë: të shkruara, të folura, vizuale, që merren nëpërmjet ndonjë metode tjetër komunikimi.

Lajmërimet mund t'i gjejmë shpesh në faqet e gazetave dhe të revistave, në televizion apo në radio.

Lajmërimet mund të jenë:

JOFORMALE

Janë njoftime që shërbejnë për informim ose komunikim në mënyrë të thjeshtë dhe jozyrtare.

FORMALE

Janë njoftime të shkruara ose të paraqitura në mënyrë zyrtare dhe profesionale për të informuar një person, organizatë ose grup të caktuar njerëzish.

Nxënësit shohin me kujdes tekstin mësimor.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe të barabarta dhe u shpërndan fletëzat e punës.

- **Grupi I** - Shkruani një lajmërim formal;
- **Grupi II** - Shkruani një lajmërim informal.

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

1. Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.
2. Ç'është lajmërimi?
3. Ku i gjejmë ato?
4. Si duhet të jenë lajmërimet?
5. Cilat janë llojet kryesore të lajmërimeve?
6. Ç'janë lajmërimet formale?
7. Jepni shembuj lajmërimesh formale?
8. Si duhet të jenë ato?
9. Ç'janë lajmërimet joformale?
10. Jepni shembuj lajmërimesh joformale?
11. Si janë ato?

Hapi i dytë (stuhi mendimessh)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për lajmërimin.

Detyrë shtëpie: Në mënyrë të pavarur shkruani një lajmërim formal ose informal.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Lajmërimi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit..

Fjalët kyçe: formale, joformale.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje të dallojë:

- lajmërimet zyrtare dhe jozyrtare, shpallje të vogla.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2, 3 dhe të punojnë në fletoren e punës.

Lexojnë me kujdes detyrën 1, 2, 3 dhe plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesave.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe të barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani një lajmërim formal;
- **GRUPI II** – Shkruani një lajmërim joformal;

- **GRUPI III** – Shkruani një lajmërim sipas dëshirës;
Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.
Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Hapi i tretë

Duke ndjekur udhëzimet e mësimdhënësit nxënësit punojnë ushtrimet e tjera në fletoren e punës. Nxënësit plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesave: Shkruani një lajmërim me të cilin drejtorja e shkollës lajmëron se do të organizohet një ekskursion me nxënësit e klasave të gjashta.


Dëgjon punën e nxënësve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(Diagrami i Venit, stuhi mendimesh)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë Diagramin e Venit duke shkruar të përbashkëtat dhe dallimet në mes të lajmërimeve formale dhe atyre joformale.



Nxënësit plotësojnë Diagramin e Venit me ndihmën e mësimdhënësit.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Plotësoni ushtrimin e fundit.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Numërori.

Burimet dhe mjetet mësimore: libri i teksti mësimor, fletorja shkollore etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: fjalë të parme, të përngjitura, të prejardhura, lokucione.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Veprimtaria e nxënësve:

- identifikojnë numërorët;
- përcaktojnë llojin e numërorëve;
- plotësojnë tabelat në grupe;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga libri i nxënësit.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Mësimdhënësi i fton nxënësit të lexojnë tekstin, ku tregohet se si Miri i vogël shkon në bibliotekën e qytetit. U kërkon të nënvizojnë numrat e shkruar me fjalë dhe ata me shifra dhe të dallojnë edhe disa numra që tregojnë radhë.

Nxënësit ndjekin me kujdes udhëzimet e mësimdhënësit.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Numërori".


Shpjegon se

NUMËRORI është ajo klasë fjalësh që tregon numra ose sasi të caktuar sendesh apo frymorësh të një fare.

Në klasën e numërorëve do të fusim vetëm ato fjalë që shënojnë

- numra (një, dy, tre, katër, pesë etj.)
- thyesa (një e dyta, një e treta, tri të pestat etj.).

Numërorët mund të jenë fjalë:



Nxënësit vështrojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Grupi I - Shkruani 4 numërorë të parmë:

Grupi II - Shkruani 4 numërorë të përngjitur:

Grupi III - Shkruani 4 numërorë të përbërë:

Grupi IV - Shkruani 4 numërorë lokucione:

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Nxënësit gjatë punës në grupe i shkëmbejnë fletët me njëri-tjetrin dhe i diskutojnë.

Përfaqësuesi i grupit i lexon detyrat e punuara në grupe dhe i sqarojnë me mësimdhënësin.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Shkruani në këto 4 kolona nga 5 numërorë të parmë, të përngjitur, të përbërë dhe lokucione.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni nga 2 fjali me secilin lloj.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Shkruani drejt numërorët: 15, 50, 25, 300, 2000, 157, 80, 79, 22, 1912.

Hapi i dytë (stuhi mendimesh)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për numërorët.

Detyrë shtëpie: Shkruani me fjalë ditëlindjen e prindërve.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Numërori.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, skeleti i peshkut;

Fjalët kyçe: fjalë të parme, të përngjitura, të prejardhura, lokucione.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave:

Shkruani me fjalë numërorët: 2, 9, 11, 23, 39, 99, 100, 107, 159, 1000, 2023.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në katër grupe të barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani me fjalë 3 numërorë të parmë;
- **GRUPI II** – Shkruani me fjalë 3 numërorë të përbërë;
- **Grupi III**- Shkruani me fjalë 3 numërorë të përngjitur;
- **GRUPI IV** – Shkruani me fjalë 3 numërorë lokucione.

Nxit nxënësit të diskutojnë brenda grupeve.

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.

Hapi i tretë


Duke ndjekur udhëzimet e mësimitdhënësit nxënësit punojnë ushtrimet e tjera në fletoren e punës. Dëgjon me vëmendje punën e nxënësve duke dhënë sugjerime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(skeleti i peshkut)

Hapi i parë

Që të vertetohen njohuroitë e arritura për numërorin fton nxënësit të punojnë me teknikën skeleti i peshkut.



Hapi i dytë

Nxënësit punojnë me teknikën skeleti i peshkut me ndihmën e mësimitdhënësit.

Nxënësit vlerësohen për njohumite e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 4 fjali, ku të përdorni numërorë të llojeve të ndryshme.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përdorimi i numërorëve.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, harta e mendjes, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: numërori, thyesat.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).
- lakimin e numërorëve.

Veprimtaria e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve të paraqitura me videoprojektor;
- plotësojnë hartën e mendjes;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Hapi i parë (stuhi mendimi)

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve. Paraqet disa pyetje në videoprojektor. Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "*Përdorimi i numërorëve*".

I fton nxënësit të lexojnë me kujdes letrën që Donika i ka shkruar Verës, me të cilën ka kaluar disa ditë në Plazhin e Ulqinit. Më pas u kërkon të dallojnë numërorët dhe të thonë pse janë përdorur. Shpjegon se: →

Numërori nuk ka kategorinë gramatikore të numrit.

Numërori *një* mund të shoqërojë vetëm emra të numrit njëjës, kurse numërorët nga *dy* e lart mund të shoqërojnë vetëm emra në numrin shumës.

Numërorët në përgjithësi nuk e kanë kategorinë gramatikore të gjinisë, p.sh.: *dy djem* – *dy vajza*, *pesë djem* – *pesë vajza* etj.

Përfundim bën vetëm numërori **tre**, i cili e ka kategorinë e gjinisë, p.sh.: **tre djem** – **tri vajza**.

Fjalët që shënojnë numra jo si njësi të plota, por si pjesë të një ose të disa njësive quhen



Nxënësit zgjidhin ushtrimet nga teksti mësimor.

Hapi i dytë (hartë e mendjes)

Nxënësit punojnë hartën e mendjes, duke shkruar se çfarë dinë për numërorët në përgjithësi.



Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Emrat *nxënës* dhe *punëtore* i përdorni në fjali të shoqëruar me numërorët 2, 3, 10, 200. Tregoni çfarë vini re.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lakoni numërorin **të tre** dhe formoni fjali, duke e përdorur në rase të ndryshme.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lexoni me kujdes tekstin e dhënë dhe bëni edhe ju një provë para klasës, duke ndarë dy molla në pjesë të ndryshme. I krahasoni ndarjet, duke i paraqitur me anë të thyesave. I shkruani drejt ato.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Shkruani drejt thyesat $3/5$, $7/8$, $3/15$ dhe formoni nga një fjali me to.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për përdorimin e numërorëve.

Detyrë shtëpie: Shkruani drejt me fjalë ditëlindjen e motrës ose të vëllait.

Planifikimi ditor 2 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përdorimi i numërorëve.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, pema e mendimit.

Fjalët kyçe: numërori, thyesat.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimi nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim).
- lakimin e numërorëve.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarime.

Realizim kuptimi- Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në katër grupe barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani me fjalë 2 numërorë të pammë;

- **GRUPI II** – Shkruani me fjalë 2 numërorë të përbërë;
- **Grupi III**- Shkruani me fjalë 2 numërorë të përngjitur;
- **GRUPI IV** – Shkruani me fjalë 2 numërorë lokucione.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve do të lexojnë mendimet përfundimtare të përfituara nga puna e përbashkët dhe do të diskutojnë rreth tyre. Bëjnë plotësime, sugjerime.

Hapi i tretë

Duke ndjekur udhëzimet e mësimit nxënësit punojnë ushtrimet e tjera në fletoren e punës. Dëgjon me vëmendje punën e nxënësve duke dhënë sugjerime.


Diskutojnë rreth detyrave të punuara në fletoren e punës.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(pema e mendimit)

Hapi i parë

Për të vërtetuar arritjet e nxënësve për numërorët mësimit përmes pyetjeve i fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit.



Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me ndihmë mësimit.

Përshkruajnë prej tabele në fletore.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani 2 fjali, ku të përdorni lloje të ndryshme numërorësh.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Teksti shkencor popullarizues.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: shkencor, informativ.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mëimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekste të njohë:

- tekste shkencore-popullarizuese të lidhura me përmbajtjet e lëndëve të tjera mësimore.

Veprimtaria e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve të paraqitura me videoprojektor;
- identifikojnë tekstin shkencor popullarizues;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqesin dhe komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre.

Organizimi i orës së mëimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Paraqet disa fotografi me videoprojektor.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të paraqitura ve videoprojektor dhe diskutojnë rreth tyre.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë *"Teksti shkencor popullarizues"*.

Mësimdhënësi thekson se:

Kanë karakter të përgjithshëm informativ.

Tekstet shkencore popullarizuese janë tekste që trajtojnë tema nga fusha të ndryshme të shkencës apo të teknologjisë, por që i drejtohen një publiku të gjerë, pra, jo specialistëve të fushës.

Në përgjithësi ato janë të shkurtra, por në atë masë sa të ruajnë vërtetësinë e kërkimit shkencor.

Gjuha e përdorur

nuk duhet të jetë krejtësisht teknike, por duhet të përshtatet me leksikun e zakonshëm, në mënyrë që asgjë nga ajo që përshkruhet të mos jetë e vështirë për t'u kuptuar nga të gjithë.

I fton nxënësit të lexojnë tekstin mësimor dhe jep sqarime sipas kërkesave.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Pyetje:

1. Ç'është teksti shkencor popullarizues?
2. Cilat janë tiparet themelore të këtyre teksteve?
3. Si duhet të jetë gjuha e tyre?
4. Për çfarë shërbejnë ato?
5. Sillni shembuj të tjerë tekstesh shkencore popullarizuese.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit i lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për tekstin shkencor popullarizues.

Detyrë shtëpie: Shkruani një shembull të tekstit shkencor popullarizues të marrë nga interneti.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Teksti shkencor popullarizues.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, skeleti i peshkut.

Fjalët kyçe: shkencor, informativ.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- tekste shkencore-popullarizuese të lidhura me përmbajtjet e lëndëve të tjera mësimore.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë dhe pyet nxënësit për mësimin e fundit.

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve lidhur me mësimin e fundit.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani një tekst shkencor popullarizues.
- **GRUPI II** – Shkruani një tekst shkencor popullarizues.

- **GRUPI III-** Shkruani një tekst shkencor popullarizues.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve do të lexojnë mendimet përfundimtare të përfituara nga puna e përbashkët dhe do të diskutojnë rreth tyre. Bëjnë plotësime, sugjerime.

I udhëzon nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës sipas kërkesave.

Fton nxënësit të shkruajnë dy shembuj tekstesh shkencore popullarizuese.


Nxënësit lexojnë tekstet e shkruara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(skeleti i peshkut)

Hapi i parë

Që të vertetohen njohuritë e arritura për tekstin shkencor popullarizues fton nxënësit të punojnë me teknikën skeleti i peshkut.



Hapi i dytë

Nxënësit punojnë me teknikën skeleti i peshkut me ndihmën e mësimdhënësit.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst shkencor popullarizues.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përemri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: vetorë, vetvetorë, dëftorë, lidhorë, pyetës, pronorë, të pacaktuar.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat (ndarja themelore dhe funksioni).

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- punojnë detyrat e dhëna në grupe;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit


Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet: Nxënësit u përgjigjen pyetjeve.

Cilat janë fjalët e ndryshueshme?

Pse quhen fjalë të ndryshueshme?



Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës


Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Përemri".

Nxënësit lexojnë me kujdes fjalitë që formohen gjatë një loje fjalësh dhe mundohen të dallojnë përemrat e shënuar me shkronja të pjerrëta.

Hapi i dytë (pema e mendimit)

Punojnë me metodën pema e mendimit duke e plotësuar në tabelë me ndihmën e mësimdhënësit..



Shikojnë me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor për llojet e përemrave.

Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I**- Shkruani 3 fjali me përemra vetvetorë;
- **Grupi II**- Shkruani 3 fjali me përemra pronorë;
- **Grupi III**- Shkruani 3 fjali me përemra të pacaktuar;
- **Grupi IV**- Shkruani 3 fjali me përemra pyetës.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre, këmbëjnë fletët me shokun dhe i plotësojnë së bashku.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Përfaqësuesit e grupit i lexojnë detyrat.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë nënvizoni përemrat dhe thoni llojin e tyre.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Pranë çdo përemri shënoni llojin.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni nga një fjali me secilin lloj përemri.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë plotësoni vendet e mbetura bosh me përemrat në kllapa.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për përemrin.

Detyrë shtëpie: Formoni 6 fjali me përemra pyetës, lidhorë e vetvetorë. I nënvizoni ata.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përemri.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit;

Fjalët kyçe: vetorë, vetvetorë, dëftorë, lidhorë, pyetës, pronorë, të pacaktuar.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat (ndarja themelore dhe funksioni).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tre grupe barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani 3 fjali dhe trego llojin e përemrave;

- **GRUPI II** – Shkruani 4 fjali me përemra pyetës e lidhorë;
- **Grupi III**- Shkruani 3 fjali me përemra dëftorë, pyetës e vetvetorë.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve do të lexojnë mendimet përfundimtare të përfituara nga puna e përbashkët dhe do të diskutojnë rreth tyre. Bëjnë plotësime, sugjerime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale)

Hapi i parë

Mësimdhënësi orienton nxënësit të plotësojnë ushtrimet nga fletorja e punës.

Hapi i dytë

Nxënësit sipas kërkesave plotësojnë fletoren e punës dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Dëgjon me kujdes punën e nxënësve dhe sqaron.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni përemrat.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përemri vetor.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, di, dua të di, mësova, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: rasë, vetë.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat vetorë;

Veprimtaria e nxënësve:

- punojnë me teknikën stuhi mendimesh;
- punojnë me metodën di, dua të di, mësova;
- lexojnë me kujdes tekstin dhe dallojnë përemrat vetorë;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

Krijon lidhje midis temës dhe njohurive të mëparshme.

Mësimdhënësi i pyet nxënësit për përemrin në përgjithësi dhe ndalet të përemri vetor.

Hapi i dytë (di, dua të di, mësova)

Mësimdhënësi vizaton tabelën di, dua të di, mësova në tabelë dhe fton nxënësit ta plotësojnë. Pyet nxënësit cila është çështja, çka dinë dhe çfarë duan të dinë.

Çështja	Di	Dua të di	Mësova
Përemri vetor.	Për përemrin në përgjithësi.	Çështje përemri vetor?	Kategorinë gramatikore të përemrit vetor.

Nxënësit plotësojnë tabelën di, dua të di, kurse mësova në fund të orës mësimore.


Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)


Shkruan titullin në tabelë "Përemri vetor", duke i ftuar nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin,

të dallojnë përemrat vetorë dhe të thonë disa veçori të tyre. Paraqitja e njohurive të reja.

Shpjegon:



Përemrat vetorë kanë tri veta për numrin njëjës dhe tri veta për numrin shumës.



Përemrat vetorë kanë kategorinë e rasës. Nxënësit vështrojnë tabelën nga teksti mësimor dhe mësimdhënësi u jep shpjegime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni nga një fjali me përemrat vetorë të çdo vete në njëjës e në shumës.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë gjeni përemrat vetorë dhe thoni se të cilës vetë janë:

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni fjali me përemra vetorë të rasave të ndryshme.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Plotësoni me përemra vetorë të rasave të ndryshme vendet e lëna bosh në tekstin e dhënë.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për përemrin vetor.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese, ku të përdorni sa më shumë përemra vetorë i nënvizoni ata.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përemri vetor.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh;

Fjalët kyçe: rasë, veta.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat vetorë.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(punë në grupe, rrjeti i diskutimit)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupetë barabarta dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani 3 fjali me përemra vetorë.
- **GRUPI II** – Shkruani 4 fjali me përemra vetorë.

- **Grupi III-** Shkruani 5 fjali me përemra vetorë.

Mësimdhënësi nxit diskutimin në mes të grupeve.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve do të lexojnë mendimet përfundimtare të përfituara nga puna e përbashkët dhe do të diskutojnë rreth tyre.

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimet në fletoren e punës

Nxënësit plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesave.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(ditari dypjesësh)

Hapi i parë

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin dypjesësh. Shkruan pyetjet lidhur me përemrin vetor dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigje.

Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë ditarin dypjesësh.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst, duke përdorur sa më shumë përemra. I nënvizoni ato.

Planifikimi ditor 3

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Trajtat e shkurtra.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: trajtë e shkurtë, rasë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat vetorë;
- lakimin e përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra të përemrit vetor.

Veprimtaria e nxënësve:

- gjejnë trajtat e shkurtra të përemrit vetor;
- në grupe punojnë detyra të ndryshme;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme.

Pyetje dhe përgjigje lidhur me përemrin vetor, duke dhënë shembuj konkretë.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Trajtat e shkurtra".

Shpjegimi i njohurive të reja.

Nxënësit lexojnë vjershën – *lojë nxënësish për të mbajtur mend* – dhe provojnë ta mësojnë përmendësh. Ndalen te fjalët me shkronja të pjerrëta.

Vështrojnë skemën e dhënë te libri i nxënësit dhe komentojnë me mësimdhënësin.

Shpjegon: Fjalëzat **më, të, i, e, na, ju, u** që dalin në rasën dhanore e kallëzore, quhen trajta të shkurtra të përemrit vetor.

Bashkimi i trajtave të shkurtra



Shpesh dy trajta të shkurtra përdoren pranë njëra-tjetrës, duke u lidhur mes tyre.

Nxënësit vështrojnë tabelën nga teksti mësimor dhe mësimdhënësi u shpjegon si janë formuar.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet punojnë detyrën:

U kërkohet të krijojnë nga dy fjali me trajta të shkurtra të përemrit vetor të tri vetave, në njëjës e në shumës.

Pasi nxënësit mbarojnë ushtrimin e tyre këmbëjnë fletët me shokun dhe i korrigjojnë së bashku.

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat e përfunduara.

Mësimdhënësi dëgjon me kujdes punën e grupeve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore, nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e mëposhtëm gjeni trajtat e shkurtra dhe thoni vetën, numrin e rasën e tyre.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë plotësoni vendet bosh me trajta të shkurtra apo me trajta të shkurtra të bashkuara sipas rastit.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e dhëna gjeni trajtat e shkurtra e ato të bashkuara dhe i analizoni.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për trajtat e shkurtra të përemrit vetor

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese, ku të përdorni sa më shumë trajtat e shkurtra të përemrit vetor. I nënvizoni ata.

Planifikimi ditor 3 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Trajta e shkurtër.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh, pema e mendimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: rasë, trajtë e shkurtër.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mëimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekst të njohin:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- përemrat vetorë.
- lakimin e përemrave vetorë dhe trajtat e shkurtra të përemrit vetor.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin dypjesësh. Shkruan pyetjet lidhur me trajtat e shkurtra dhe fton nxënësit të plotësojnë.


Pyetja	Përgjigje.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës
(pema e mendimit, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Përmes pemës së mendimit nxënësit tregojnë se çfarë kanë mësuar për përemrin në përgjithësi.



Hapi i dytë

Nxënësit plotësojnë pemën e mendimit me ndihmën e mësuesit.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe nënvizoni përemrat.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përshkrimi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: objektiv, subjektiv, personazh, mjedis, peizazh, proces, ndjenja e mendime.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jetë në gjendje të njohë:

përshkrimin e llojet e tij (p.sh. përshkrimi i jetës së moshatarëve, përshkrimi i lojërave, zejeve, sporteve; përshkrimi i ambientit; përshkrimi i jetës së njerëzve dikur dhe sot, përshkrimi i ngjarjeve në natyrë, përshkrimi i zhvillimit të njeriut/ kafshës, përshkrimi i bimëve, përshkrimi i sendeve, prodhimeve, makinave).

Veprimtaria e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve të paraqitura përmes videoprojektorit;
- punojnë me metodën pema e mendimit;
- punojnë detyrat e dhëna në grupe;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Lëshon disa fotografi me videoprojektor.

U kërkon nxënësve të përshkruajnë se çfarë shohin në fotot e paraqitura.


Ndërtimi i njohurive të reja.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës.

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Përshkrimi"

Shpjegon se:




I fton nxënësit të lexojnë me kujdes përshkrimin dhe të tregojnë ç'mjete gjuhësore janë

përdorur.

Hapi i dytë (pema e mendimit)

Punojnë me metodën pema e mendimit, duke e plotësuar në tabelë me ndihmën e mësuesit.



Me kujdes përcjellin tekstin mësimor lidhur me llojet e përshkrimit.

Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Të gjithë grupet përshkruajnë mjedisin e shkollës në forma të ndryshme.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale u përgjigjen kërkesave të tekstit mësimor.

1. Ç'është përshkrimi?
2. Cilat janë llojet e përshkrimit?
3. Përshkruani një person në mënyrë objektive.
4. Përshkruani një person në mënyrë subjektive.
5. Përshkruani mjedisin e shtëpisë suaj.
6. Përshkruani një dukuri.

Hapi i katërt (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për përshkrimin.

Detyrë shtëpie: Përshkruani oborrin e shtëpisë.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Përshkrimi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh, harta e mendjes, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: objektiv, subjektiv, personazh, mjedis, peizazh, proces, ndjenja e mendime.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mëimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mëimit nxënësit do të jetë në gjendje të njohë:

përshkrimin e llojet e tij (p.sh. përshkrimi i jetës së moshatarëve, përshkrimi i lojërave, zejeve, sporteve; përshkrimi i ambientit; përshkrimi i jetës së njerëzve dikur dhe sot, përshkrimi i ngjarjeve në natyrë, përshkrimi i zhvillimit të njeriut/ kafshës, përshkrimi i bimëve, përshkrimi i sendeve, prodhimeve, makinave).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, ditari dypjesësh)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

Mësimdhënësi vizaton në tabelë ditarin dypjesësh. Shkruan pyetjet lidhur me përshkrimin dhe fton nxënësit të plotësojnë.

Pyetja	Përgjigje.


Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(harta e mendjes, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Që të vërtetohen arritjet e nxënësve mësimdhënësi përmes pyetjeve drejtuar nxënësve vijon me plotësimin e hartës së mendjes.



Hapi i dytë

Bashkë me nxënësit bëjnë një përmbledhje të njohurive të arritura për përshkrimin.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Përshkruani shokun/shoqen e bankës.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Folja.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: folje ndihmëse, kalimtare, jokalistare.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- foljen.

Veprimtaria e nxënësve:

- identifikojnë foljet ndihmëse **kam** dhe **jam**;
- identifikojnë foljet kalimtare dhe jokalistare;
- në grupe punojnë detyra të ndryshme;
- në fletoren e punës punojnë ushtrime nga teksti mësimor;
- paraqesin dhe komunikojnë lirshëm e saktë mendimin e tyre.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi i fton nxënësit të lexojnë tekstin, të gjejnë foljet dhe të përpiqen për të dalluar mënyrën dhe kohën e tyre.

Nxënësi përgjigjet në fletore kërkesës së mësimdhënësit.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Folja".

Shpjegon: Folje quhet ajo klasë fjalësh që emërton një veprim ose gjendje të kryefjalës.

Folja është gjymtyrë kryesore e fjalisë dhe ka kategorinë gramatikore të vetës, të numrit, të mënyrës, të kohës dhe të diatezës.

Folje ndihmëse janë




dhe



Ato shërbejnë për të ndërtuar format

e kohëve të përbëra të foljeve: *kam bërë, kisha larë, pata punuar; jam larë, isha krehur, qeshë zemëruar* etj.

Të gjitha foljet sipas mundësisë që kanë për të marrë ose jo një kundrinor të drejtë në fjali ndahen në dy grupe të mëdha:

kalimtare  jokalistare

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësuesi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I** – Shkruani tri fjali me foljen ndihmëse **kam**.
- **Grupi II** – Shkruani tri fjali me foljen ndihmëse **jam**.
- **Grupi III** – Shkruani tri fjali me folje kalimtare.
- **Grupi IV** – Shkruani tri fjali me folje jokalistare.

Hapi i tretë (rrjeti i diskutimit)

Përfaqësuesit grupit lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimpldhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë nënvizoni foljet dhe thoni se çfarë tregojnë.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë gjeni foljet. Thoni kur foljet **kam** e **jam** përdoren me kuptim të plotë leksikor dhe kur si folje ndihmëse.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë gjeni foljet dhe i vendosni në tabelë.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimpldhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për foljen.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese dhe nënvizoni foljet kalimtare e jokalistare.

Planifikimi ditor 1 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Folja.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, harta e mendjes, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: folje ndihmëse, kalimtare, jokalistare.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mësimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- foljen.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në katër grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Shkruani 3 fjali me folje kalimtare.

- **GRUPI II** - Shkruani 3 fjali me folje jokalmtare.
- **GRUPI III** - Shkruani 4 fjali me folje kalimtare.
- **GRUPI IV**- Shkruani 4 fjali me folje jokalmtare.

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.


Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(harta e mendjes, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Që të vërtetohen arritjet e nxënësve mësimdhënësi përmes pyetjeve vijon me plotësimin e hartës së mendjes.



Hapi i dytë

Bashkë me nxënësit krijojnë një përmbledhje të njohurive të arritura për foljen.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani nga 4 fjali me folje kalimtare dhe jokalmtare.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kategoritë gramatikore të foljes.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, INSERT, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: mënyrë, kohë, vetë, numër.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimi nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimi nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- foljen dhe kategoritë e saj gramatikore.

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë kategoritë gramatikore të foljes;
- punojnë me teknikën INSERT;
- në grupe punojnë detyra të ndryshme;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimi

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (INSERT)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin, si kujtim i përjetshëm për mësuesen e parë, të gjejnë foljet dhe të kujtojnë veçoritë e tyre gramatikore.

Bëhet edhe plotësimi i mëtejshëm i tabelës së INSERTIT.

√	+	-	?
Njohuritë e reja që nxënësi merr dhe arrin t'i kuptojë.	Njohuritë që i ka mësuar më parë.	Njohuritë e reja që janë ndryshe nga ato që di ose mendon se i di.	Njohuritë e reja që nuk arrin t'i kuptojë.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Kategoritë gramatikore të foljes".

Shpjegon:

Folja ka kategorinë gramatikore: **të vetës, të numrit, të mënyrës, të kohës, të diatezës**

Mënyrat e foljes janë:



Format e pashtjelluara të foljes janë:



Me ndihmën e mësimdhënësit nxënësit zgjidhin ushtrime nga teksti mësimor, duke kujtuar kohët themelore të foljes.

Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I** - Formoni fjali me foljet *lexoj* e *shkruaj*, duke i përdorur në mënyrën kushtore dhe habitore.
- **Grupi II** - Formoni fjali me foljet *punoj* e *vrapij*, duke i përdorur në formën e pashtjelluar pjesore dhe mohore.
- **Grupi III** - Formoni fjali me foljet *lexoj* e *shkruaj*, duke i përdorur në mënyrën dëshirore dhe urdhërore.
- **Grupi IV** - Formoni fjali me foljet *vrapij* e *punoj*, duke i përdorur në formën e pashtjelluar paskajore dhe përcjellore.

Dëgjoni punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në tekstin e dhënë gjeni foljet.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Përcaktoni numrin, vetën dhe mënyrën e foljeve. Thoni nëse veprimi kryhet në të tashmen, në të shkuarën apo në të ardhmen.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Formoni fjali me foljet *mësoj* dhe *hap*, duke i përdorur në të gjitha mënyrat.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e mëposhtme plotësoni vendet bosh me foljet që mungojnë.

Punohet ushtrimi 5 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e mëposhtme nënvizoni me një vijë format e shtjelluara të foljeve e me dy vija format e pashtjelluara. Thoni llojin e tyre.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësit vlerësohen për njohuritë e fituara për kategoritë gramatikore të foljes.

Detyrë shtëpie: Hartoni një ese dhe dalloni foljet.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kategoritë gramatikore të foljes.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, teknika e kubimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: mënyrë, kohë, vetë, numër.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mëimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë pjesët e ndryshueshme të ligjëratës.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mëimit nxënësi do të jetë në gjendje që në tekst të njohë:

- pjesët e ndryshueshme të ligjëratës (fjalët me lakim dhe fjalët me zgjedhim);
- foljen dhe kategoritë e saj gramatikore.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënëse - nxënëse.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **GRUPI I** – Krijoni fjali me foljet *lexoj* dhe *shkoj*, duke i përdorur në të gjitha mënyrat.
- **GRUPI II** – Plotësoni tabelën nga fletorja e punës, duke i vendosur foljet në vetën e parë, numrin njëjës, kohën e tashme, të çdo mënyre.
- **GRUPI III** - Plotësoni tabelën, duke i vendosur foljet në të gjitha format e pashtjelluara.

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat nga puna e përbashkët.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.


Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(teknika e kubimit, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Që të vërtetohen arritjet e nxënësve mësimdhënësi përmes pyetjeve vijon me teknikën e kubimit.

Mësimdhënësi paraqet detyrën.



Mësimdhënësi në të gjitha faqet e kubit shkruan një kërkesë dhe nxit nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve.

Nxënësit shkëmbejnë përgjigjet për secilën faqe të kubit.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për kategoritë gramatikore të foljes.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese dhe nënvizoni foljet.

Planifikimi ditor 1 (Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Anketa.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: pyetje, përgjigje, anonim, me shkallë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të gjendje:

- të dëgjojnë biseda të incizuara dhe të përgatisin vetë të ngjashme;
- të njohin anketat.

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë anketën;
- përcaktojnë llojin e anketimit;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

U kërkon nxënësve nëse dinë diçka për anketën dhe a kanë marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë anketim. Nxënësit shprehin mendimet e veta.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës


Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Anketa".

Ndërtim i njohurive të reja. Shpjegon:


Anketa është mjet i përdorur për të marrë informacion nga një grup njerëzish. Ato janë pyetje që u bëhen shumë njerëzve njëkohësisht, me qëllim që të mësojmë më shumë lidhur me atë që ata mendojnë ose ndjejnë.

Anketimi është disa llojesh dhe mund të klasifikohet sipas disa kritereve:



I fton nxënësit që të shohin tekstin mësimor dhe jep sqarimet sipas kërkesave.

Dallojnë gjithashtu:



Hapi i dytë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

Secili grup shkruan një anketë dhe e lexon para klasës.

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve, duke iu përgjigjur kërkesave:

1. Ç'është anketa?
2. Cilat janë temat që mund të mbulojë një anketë?
3. Cilat janë kriteret bazë për klasifikimin e anketave?
4. Përmendni llojet kryesore të anketave.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për anketën.

Detyrë shtëpie: Hartoni një anketë.

Planifikimi ditor 1 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Anketa.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: pyetje, përgjigje, anonim, me shkallë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë në gjendje:

- të dëgjojnë biseda të incizuara dhe të përgatisin vetë të ngjashme;
- të njohin anketat.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tre grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Secili grup shkruan një anketë.

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat nga puna e përbashkët.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin në fletoren e punës dhe të shkruajnë një anketë sipas dëshirës. Nxënësit plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesës.

Fton nxënësit të shkruajnë një anketë.

Nxënësit shkruajnë anketën.

Hapi i dytë

Lexojnë anketat e shkruara dhe diskutojnë bashkë me mësimdhënësin.

Detyrë shtëpie: Shkruani një anketë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 2

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Si të hartojmë një anketë?

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, pema e mendimit, rrjeti i diskutimit.

Fjalët kyçe: anketë, qëllim, pyetje, përgjigje, testim, analizë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të gjendje:

- të dëgjojnë biseda të incizuara dhe të përgatisin vetë të ngjashme;

Veprimtaria e nxënësve:

- u përgjigjen pyetjeve;
- lexojnë me kujdes anketat nga teksti mësimor;
- në fletoren shkollore punojnë ushtrimet nga teksti mësimor;
- paraqesin dhe komunikojnë lirshëm dhe saktë mendimin e tyre.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë. Pyetje dhe përgjigje lidhur me anketën.


Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë “Si të hartojmë një anketë?”.

I fton nxënësit të lexojnë me kujdes anketat nga libri i nxënësit.

Thekson se:



Hapi i dytë (pema e mendimit)

Fton nxënësit të plotësojnë pemën e mendimit.



Hapi i tretë (punë në grupe)

Mësimdhënësi i ndan nxënësit në dy grupe të barabarta dhe secilit grup i shpërndan fletëzat me detyrën përkatëse, duke u caktuar kohën për të punuar detyrën dhe kryetarin e grupit, i cili do të prezantojë detyrën.

- **Grupi I** - Hartoni një anketë me temë "*Biblioteka e qytetit*";
- **Grupi II** - Hartoni një anketë me temë "*Pushimet verore*".

Përfaqësuesit e grupit lexojnë detyrat e punuara.

Dëgjon punën e grupeve dhe, kur është e nevojshme, jep sqarime.

Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimdhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

1. Çfarë është anketimi dhe pse realizohet ai?
2. Cilat janë hapat që duhet të ndjekim për të bërë një anketim?

Hapi i dytë (rrjeti i diskutimit)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për hartimin e një ankete.

Detyrë shtëpie: Shkruani një anketë.

Planifikimi ditor 2

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Si të hartojmë një anketë.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: anketë, qëllim, pyetje, përgjigje, testim, analizë.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi do të jetë i aftë të dëgjojë, të lexojë, të kuptojë, të analizojë dhe të krijojë tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tij.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të gjendje:

- të dëgjojnë biseda të incizuara dhe të përgatisin vetë të ngjashme;

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tre grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

- **Grupi I - Shkruani një anketë për ruajtjen e mjedisit.**
- **Grupi II - Shkruani një anketë për rëndësinë e sportit.**
- **Grupi III - Shkruani një anketë për rëndësinë e shkollimit.**

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat nga puna e përbashkët.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(punë individuale, bashkëbisedim)

Hapi i parë

I fton nxënësit të plotësojnë ushtrimin në fletoren e punës sipas kërkesës.

Nxënësit plotësojnë fletoren e punës sipas kërkesës:

Hartoni një anketë me temën:

Leximi dikur dhe sot.

Nxënësit shkruajnë anketën me temën e dhënë.

Hapi i dytë

Lexojnë anketat e shkruara dhe diskutojnë bashkë me mësimdhënësin. Vlerëson punën e nxënësve.

Detyrë shtëpie: Shkruani një anketë sipas dëshirës.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kryefjala.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: kryefjalë, emër, përemër, numëror, GE.

Rezultati edukativo-arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekste të njohin:

- kryefjalën.

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë kryefjalën;
- dallojnë me cilat pyetje gjendet dhe me çfarë shprehet;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësuesi fton nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin dhe të nënvizojnë me një vijë kryefjalët.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i dytë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Kryefjala".


Shohin me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor.

Shpjegon se: —————> Kryefjala është gjymtyrë kryesore e fjalisë.

Ajo tregon se kush (cili) e kryen apo e pëson veprimin e shprehur nga folja-kallëzues.

Gjendet me pyetjet: —————> *kush? cili? cila? cilët? cilat?*

Shprehet me:



Nëse ka pyetje, diskutohen nga vetë nxënësit dhe jepen sqarimet e nevojshme nga mësimpldhënësi.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lexoni fjalitë e dhëna dhe gjeni kryefjalën; tregoni me se shprehet.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Gjeni kryefjalën në fjalitë e tekstit të dhënë; tregoni me çfarë shprehet dhe shkruani pyetjet që duhen bërë për ta gjetur atë.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë e dhëna nënvizoni me një vijë kryefjalën. Në vendet e lëna bosh shkruani pyetjet që përdorni për të gjetur kryefjalën.

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Dalloni kryefjalët dhe plotësoni tabelën më poshtë me të dhëna për këtë gjymtyrë kryesore.

Punohet ushtrimi 5 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Plotësoni vendet e lëna bosh në tekstin e dhënë me fjalët në kllapa.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit lexojnë detyrat e punuara dhe i komentojnë me mësimpldhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për kryefjalën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese dhe nënvizoni kryefjalët.

Planifikimi ditor 1 (Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kryefjala

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, skeleti i peshkut.

Fjalët kyçe: kryefjalë, emër, përemër, numëror, GE.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Arritjet e të nxënit:

Gjatë mësimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekste të njohin:

– kryefjalën.

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1 e 2 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1 e 2 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Grupi I - Shkruani 3 fjali dhe nënvizoni kryefjalën.

Grupi II - Shkruani 4 fjali dhe nënvizoni kryefjalën.

Grupi III - Shkruani një tekst dhe gjeni kryefjalën.

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat nga puna e përbashkët.


Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(skeleti i peshkut)

Hapi i parë

Që të vertetohen njohuritë e arritura për kryefjalën fton nxënësit të punojnë me teknikën skeleti i peshkut.



Hapi i dytë

Nxënësit punojnë me teknikën skeleti i peshkut me ndihmën e mësimitdhënësit.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe dalloni kryefjalët.

Planifikimi ditor 1

(Ora e parë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kallëzuesi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: kallëzues, emëror, foljor.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mësimimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Arritjet e të nxënësit:

Gjatë mësimimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekste të njohin:

- kallëzuesin dhe llojet e tij (kallëzuesin emëror dhe atë foljor).

Veprimtaria e nxënësit:

- identifikojnë kallëzuesin foljor;
- dallojnë me cilat pyetje gjendet dhe me çfarë shprehet;
- identifikojnë kallëzuesin emëror;
- dallojnë me çfarë shprehet;
- në fletoren e punës punojnë ushtrimet nga teksti mësimor.

Organizimi i orës së mësimimit

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

Hapi i parë (stuhi mendimesh)

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Mësimdhënësi i fton nxënësit të lexojnë me kujdes tekstin nga libri i nxënësit dhe të dallojnë foljet – kallëzues për secilën fjali, duke thënë çfarë tregojnë ato. Nxënësit ndjekin udhëzimin e mësimdhënësit.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

Hapi i parë (informacion i ri)

Mësimdhënësi shkruan titullin në tabelë "Kallëzuesi".

Shohin me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor.


Shpjegon se: Kallëzuesi është gjymtyrë kryesore e fjalisë dhe shprehet me folje.

Ai është gjithnjë në lidhje me kryefjalën dhe anasjelltas. Ato nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin.

Gjendet me pyetjet:

ç'bën?, ç'bëjnë?, si është?, si janë? ç'/çfarë është?

Sipas mënyrës së shprehjes, kallëzuesi mund të jetë dy llojesh: kallëzues emëror dhe kallëzues foljor.



Nxënësi shikon me kujdes ushtrimet nga teksti mësimor.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

Hapi i parë (punë individuale)

Në këtë fazë të orës mësimore nxënësit në grupe dhe në mënyrë individuale punojnë me rubrikën e ushtrimeve.

Punohet ushtrimi 1 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lexoni fjalitë e dhëna dhe gjeni kallëzuesit, duke vënë në vendet e lëna bosh pyetjet e duhura.

Punohet ushtrimi 2 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Lexoni tekstin e dhënë. Dalloni kallëzuesit dhe i analizoni ato, duke treguar me se janë shprehur. I vendosni në tabelë.

Punohet ushtrimi 3 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Në fjalitë më poshtë dalloni kur folja “jam” është përdorur si këpujë e kallëzuesit emëror dhe, kur del me kuptimin “gjendem”, si kallëzues foljor. (Kini kujdes kur kjo folje është përdorur si folje ndihmëse për kohët e përbëra, si: *jam larë, jam nisur, jam përgatitur* etj.).

Punohet ushtrimi 4 sipas kërkesës nga teksti mësimor:

Plotësoni fjalitë e lëna përgjysmë. Shënoni me ngjyrë të **kuqe** kallëzuesit e thjeshtë foljorë, me ngjyrë **blu** kallëzuesit e përbërë foljorë dhe me ngjyrë **jeshile** kallëzuesit emërorë.

Hapi i dytë (bashkëbisedim)

Nxënësit i lexojnë detyrat dhe i komentojnë me mësimdhënësin.

Vlerësimi: Nxënësi vlerësohet për njohuritë e fituara për kallëzuesin.

Detyrë shtëpie: Shkruani një ese dhe nënvizoni kallëzuesit. Thoni llojet e tyre.

Planifikimi ditor 1

(Ora e dytë)

Libër mësuesi

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Klasa VI

Rubrika: Njohuri për gjuhën.

Tema mësimore: Kallëzuesi.

Burimet dhe mjetet mësimore: teksti mësimor, fletorja e punës etj.

Format e punës: frontale, individuale, në grupe.

Metodat dhe teknikat e realizimit: stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit, harta e mendjes, bashkëbisedim.

Fjalët kyçe: kallëzues, emëror, foljor.

Rezultati edukativo - arsimor

Në fund të mëimit nxënësi/-ja do të jetë i/e aftë të dallojë dhe të emërtojë gjymtyrët kryesore të fjalisë.

Arritjet e të nxënës:

Gjatë mëimit nxënësit do të jenë të aftë që në tekste të njohin:

- kallëzuesin dhe llojet e tij (kallëzuesin emëror dhe atë foljor).

Struktura e orës

Puna në klasë do të bazohet në veprimtarinë e dyanshme
mësimdhënës - nxënës.

Gjatë kësaj ore nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës.

Evokim - Pjesa hyrëse e orës

(stuhi mendimesh, punë individuale)

Hapi i parë

Ora mësimore fillon me këtë aktivitet:

Kontrollon detyrat e shtëpisë.

I fton nxënësit të lexojnë detyrën 1, 2, 3 dhe të punojnë në fletoren e punës sipas kërkesave.

Lexojnë me kujdes detyrën 1,2, 3 dhe plotësojnë fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve. Diskutojnë rreth kërkesave të ushtrimeve.

Realizim kuptimi - Pjesa kryesore e orës

(rrjeti i diskutimit, punë në grupe)

Hapi i parë

Fton nxënësit të punojnë detyrat në vazhdim sipas kërkesave.

Nxënësit lexojnë me kujdes detyrat dhe i plotësojnë në fletoren e punës.

Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sugjerime.

Hapi i dytë

I ndan nxënësit në tri grupe dhe u shpërndan fletëzat me pyetjet e përgatitura.

Grupi I - Shkruani 3 fjali dhe nënvizoni kallëzuesin.

Grupi II - Shkruani 4 fjali dhe nënvizoni kallëzuesin.

Grupi III - Shkruani një tekst dhe gjeni kallëzuesin.

Përfaqësuesit e secilit grup do të lexojnë detyrat nga puna e përbashkët.


Dëgjon me kujdes përgjigjet e nxënësve dhe jep sqarimet e nevojshme.

Reflektim - Pjesa përfundimtare e orës

(harta e mendjes, bashkëbisedim)

Hapi i parë

Që të vërtetohen arritjet e nxënësve mësimdhënësi përmes pyetjeve vijon me plotësimin e hartës së mendjes.



Hapi i dytë

Bashkë me nxënësit bëjnë një përmbledhje të njohurive të arritura për kallëzuesin.

Nxënësit vlerësohen për njohuritë e arritura për orën.

Detyrë shtëpie: Shkruani një tekst dhe dalloni kallëzuesin.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 1

Lexoni vargjet e poezisë “Gjuha shqype” nga Ndre Mjeda dhe përgjigjuni pyetjeve:

*“Por me gjuhë kaq t’moçme e mjera
si nj’bij’kjo që pa prind mbet:
për t’huej t’mbajshin dhenat tjera,
s’t’kishte kush për motër t’vet.”*

1. Në cilin dialekt janë shkruar vargjet e dhëna?

(1 pikë)

2. Shkruaje në gjuhën standarde vargun “Por me gjuhë kaq t’moçme e mjera”

(1 pikë)

3. Çfarë formojnë fjalët që kanë një rrënjë të përbashkët?

(1 pikë)

4. Fjala e nënvizuar në fjalinë “Në bregdet ka shumë njerëz” është:

a. e përbërë

b. e prejardhur

Rretho përgjigjen e saktë

(1 pikë)

5. Formo fjalë të përbëra me fjalët:

bashkë _____

(1 pikë)

flokë _____

(1 pikë)

6. Fjalët jo të parme janë:


(1 pikë)

7. Vendosini në kolonën përkatëse fjalët: *punë, dritë, shkrimtar, vendbanim, faleminderit, hekurudhë, zemërgurë, ndërtim, gjithmonë.*

Fjalë të parme	Fjalë të prejardhura	Fjalë të përbëra	Fjalë të përngjitura

(3 pikë)

8. Formo familje fjalësh me fjalën **RRUGË**.



Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

(4 pikë)

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI TEST NR. 2

Lexoni me kujdes bisedën dhe përgjigjuni pyetjeve në vazhdim.

Iliri: Alo. Përshëndetje.

Artini: Përshëndetje, Ilir. Ç'kemi?

Iliri: Asgjë e veçantë, në shtëpi, përpara televizorit.

Artini: A je i lirë në darkë për në kinema? Po shfaqet një film i ri.

Iliri: Nuk është ide e keqe. Cili film?

Artini: Është një komedi. Kam lexuar disa komente pozitive rreth këtij filmi. Mendoj se është e nevojshme të shihet.

1. A) Biseda e mësipërme është:

1. zyrtare,

2. jozyrtare.

Rretho përgjigjen e saktë.

(1 pikë)

B) Argumento përgjigjen.

(1 pikë)

2. Plotësoni tabelën:

Fjalë të ndryshueshme	Shembuj	Fjalë të pandryshueshme	Shembuj
Emri		Ndajfolja	
Mbiemri		Parafjala	
Përemri		Lidhëza	
Numërori		Pjesëza	
Folja		Pasthirrma	

(5 pikë)

3. Lidhni me një vijë fjalën me klasën në të cilën bën pjesë:

lexoj		lidhëz,
bobo		pjesëz,
nga		pasthirrmë,
vajzë		emër,
ju		përemër,
i bukur	folje,	
tetë		ndajfolje,
mirë		parafjalë,
sonte		mbiemër,
nuk		numëror.

(3

pikë)

4. Plotësoni tabelën, duke shkruar emra konkretë dhe abstraktë.

Koncretë	Abstraktë

(2 pikë)

5. Në fjalinë "Zhurma e fëmijëve të fshatit më gëzonte.", fjala e nënvizuar është në rasën:

(1 pikë)

6. Shkruani rasat e tjera të emrit:

_____ (1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 3

1. Cilat janë objektivat e reklamave?

(1 pikë)

2. Cilit vit i përket reklama e parë e shtypur ? _____

(1 pikë)

3. Shkruani katër karakteristika të reklamës.

(1 pikë)

(1 pikë)

4. Fjalët me shkronja të zeza: *djalë i mirë*, *vajzë e bukur*, janë:

- a. emra
- b. përemra
- c. mbiemra

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

5. Plotësoni tabelën:

Mbiemra të nyjshëm	Mbiemra të panyjshëm

(4 pikë)

6. A) Shkruani si e formojnë gjininë femërore mbiemrat e nyjshëm.

(1 pikë)

B) Argumentojeni me një shembull.

(1 pikë)

7. A) Në cilën shkallë është mbiemri në fjalinë: *Ulqini është qytet i bukur*.

(1 pikë)

B) Rishkruajeni fjalinë, duke e shkruar mbiemrin në shkallët e tjera.

(1 pikë)

(1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftue- shëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqye- shëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 4

1. Shkruani si ndërtohet lajmi?

_____ (1 pikë)

2. Lajmi që i referohet vetëm veprimit është lajm:

_____ (1 pikë)

3. Cili lajmërim ka për qëllim të informojë në mënyrë zyrtare?

1. formal

2. joformal

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

4. Plotësoni tabelën e mëposhtme, duke shënuar në kolonën përkatëse nga 4 numërorë të parmë, të përngjitur, të përbërë dhe lokucione.

të parmë	të përngjitur	të përbërë	lokucione

(4 pikë)

5. Shkruani me fjalë numërorët:

25 _____ (1 pikë)

250 _____ (1 pikë)

6. Cili numëror e ka kategorinë gramatikore të gjinisë?

_____ (1 pikë)

7. Shkruani drejt thyesat:

2/7 _____ (1 pikë)

3/5 _____ (1 pikë)

8. Shkruani një lajm, duke u mbështetur te pyetjet e lajmit.

(2 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 5

1. Shkruani si duhet të jetë gjuha e tekstit shkencor popullarizues?

_____ (1 pikë)

2. Lexoni me kujdes fjalitë dhe shkruani dy përemra:

1. Kush i ndez këtu këta qirinj?
2. Çfarë ndriçon kjo dritë e zbehtë?
3. Shiko mirë, e kupton ti vetë.

_____ (2 pikë)

3. Pranë çdo përemri shënoni llojin:

kjo	_____
yt	_____
cili	_____
vetja	_____
ju	_____
secili	_____
i këtillë	_____
i cili	_____
askush	_____.

(4 pikë)

4. Formoni dy fjali me përemra dëftorë dhe dy fjali me përemra pronorë.

_____	(1 pikë)
_____	(1 pikë)
_____	(1 pikë)
_____	(1 pikë)

5. Shkruani dy fjali me përemra vetorë.

_____	(1 pikë)
_____	(1 pikë)

6. Fjalëzat *më, të, i, e, na, ju, u* quhen:

(1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 6

1. Përshkrimi që përfshin mendimet dhe ndjenjat e atij që shkruan, duke e bërë atë më emocional dhe më shprehës është përshkrim:

_____ (1 pikë)

2. Shkruani llojet e tjera të përshkrimit:

_____, _____, _____, _____, _____. (1 pikë)

3. Shkruani dy fjali me folje kalimtare dhe jokalistare:

_____ (1 pikë)

_____ (1 pikë)

4. Cilat janë kategoritë gramatikore të foljes?

_____ (2 pikë)

5. Përshkruajeni oborrin e shkollës. Nënvizoni foljet:

_____ (4 pikë)

6. Plotësoni tabelën, duke shkruar nga një fjalë me folje në secilën mënyrë:

1.	mënyra dëftore	
2.	mënyra habitore	
3.	mënyra lidhore	
4.	mënyra kushtore	
5.	mënyra dëshirore	
6.	mënyra urdhërore	

(4 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KLASA VI

TEST NR. 7

1. Anketimi për nga identifikimi mund të jetë:

_____. (1 pikë)

2. Çfarë duhet të përcaktojmë për të hartuar një anketë?

_____. (2 pikë)

3. Shkruani tri fjali të plota dhe tregoni me se shprehet kryefjala.

_____. (1 pikë)

_____. (1 pikë)

_____. (1 pikë)

4. Me cilat pyetje gjendet kryefjala?

_____. (1 pikë)

5. Me cilat pyetje gjendet kallëzuesi?

_____. (1 pikë)

6. A) Në fjalinë "Ora është nëntë" fjala e nënvizuar është:

1. kallëzues emëror,

2. kallëzues foljor.

Rrethoni përgjigjen e saktë

(1 pikë)

B) Tregoni me se shprehet.

_____. (1 pikë)

7. Shkruani dy fjali me kallëzues emëror dhe dy fjali me kallëzues foljor:

_____. (1 pikë)

_____. (1 pikë)

_____. (1 pikë)

_____. (1 pikë)

Vlerësimi	pamjaftueshëm (1)	mjaftueshëm (2)	mirë (3)	shumë mirë (4)	shkëlqyeshëm (5)
Pikët (14)	0-3	4-6	7-9	10-12	13-14

ZGJIDHJA E USHTRIMEVE

BOTA E FJALËVE

GJUHË SHQIPE

6

(Fletore e punës)

1. GJUHA AMTARE

1. a. Është ajo gjuhë të cilën njeriu e mëson që në fëmijëri dhe që e përdor në mjedisin familjar.
- b. UNESCO në vitin 1999 e ka shpallur 21 shkurtin Ditë ndërkombëtare të gjuhës amtare.
- c. Edukimi në gjuhën amtare është një detyrë, e cila duhet të përmbushet nga çdo individ i një kombi.
- 2.
3. a. Në disa vende, termi gjuhë amtare i referohet gjuhës së një komuniteti etnik;
4. Një pjesë e popullsisë në Mal të Zi, që janë shqiptarë etnikë, përdor shqipen si gjuhë amtare.

2. GJUHA STANDARDE DHE GJUHA ZYRTARE

- 1: a. Është një variant i një gjuhe që është i përcaktuar nga autoritetet gjuhësore dhe që përdoret si model për shkrimin dhe të folurit në mjedise zyrtare dhe formale.
- b. Zakonisht përdoret në media, libra dhe në dokumente apo komunikime zyrtare.
- c. Në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, të zhvilluar në Tiranë në vitin 1972.
- 2.
- 3: a. Është ajo gjuhë që është e pranuar zyrtarisht nga një shtet për përdorimet shtetërore, kryesisht për të shkruar dokumentet zyrtare dhe për të komunikuar në nivel shtetëror.
- b. Përdoret në dokumentet dhe komunikimet qeveritare, në gjykata, në shkollë dhe në të gjitha format e tjera të komunikimit shtetëror.
4. Përveç malazezishtes, që është gjuha zyrtare e shtetit, ka edhe grupe të tjera etnike që flasin gjuhët e tyre amtare (shqipja, boshnjakishtja, serbishtja, kroatishtja etj.).
5. Shqipja është në përdorim zyrtar në disa komuna të Malit të Zi, si: Tuz, Ulqin, Plavë e Guci, ku shqiptarët përbëjnë një pjesë të madhe të popullsisë.
- 6.

3. DIALEKTI

1. Është një variant i gjuhës, i cili përdoret si mjet komunikimi për një bashkësi njerëzish pak a shumë të vogël, të cilët jetojnë në zona të caktuara gjeografike.
- 2.
- a. Gjuha shqipe ka dy dialekte: gegërishten dhe toskërishten.
- b. Flitet në pjesën veriore të Shqipërisë, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoninë Veriore dhe në Serbi.
- c. Flitet në jug të Shqipërisë, në një pjesë të vogël të Maqedonisë, në Greqi dhe në Italinë jugore nga arbëreshët (arbërishtja).
- 3.

Dialekt	Gjuhë standarde
Tamel	qumësht
Syni	syri

Krye	koka
Nanë	nëna
Zani	zëri
Nadje	mëngjes
Zotni	zotëri

4. Është një njësi edhe më e vogël, që përfaqëson gjuhën apo dialektin e përdorur nga njerëzit në një zonë më të vogël gjeografike se dialekti, p.sh.: e folmja e Shkodrës etj.

5. Skuq, nxënësi, fshehurazi.

6.

1. STRUKTURA E FJALËS

Tema dhe mbaresa

1. Mbaresë quhet ajo pjesë e fjalës që ndryshon gjatë përdorimit në fjali. Temë quhet pjesa e fjalës që mbetet pasi hiqet mbaresa.

2. *nxënës – tema* *-it – mbaresa,* *puno – tema* *-jmë – mbaresa,*
la – tema *-hem – mbaresa,* *fillo – tema* *-nte – mbaresa,*
shkro – tema *-va – mbaresa,* *rri – tema* *-nte – mbaresa,*
hap – tema *-nin – mbaresa,* *popull – tema* *-in – mbaresa.*

3. *natyr(ë) – tema* *-a – mbaresa,* *element – tema* *-eve – mbaresa,*
qenie – tema *-ve – mbaresa,* *imagjino – tema* *-ni – mbaresa,*
ngrohtësi – tema *-në – mbaresa,* *dritë – tema* *-n – mbaresa,*
mëngjes – tema *-i – mbaresa,* *lule – tema* *-ve – mbaresa,*
ringjallje – tema *-je – mbaresa,* *dëgjo – tema* *-hen – mbaresa,*
këndo – tema *-jnë – mbaresa,* *formo – tema* *-jnë – mbaresa,*
shpirt – tema *-in – mbaresa,* *njeri – tema* *-ut – mbaresa.*

4. *lajmëro – tema* *-jmë – mbaresa,* *lajmëroj,*
mbill – tema *-ni – mbaresa,* *mbjell,*
nxito – tema *-nte – mbaresa,* *nxitoj,*
ardh – tema *-ur – mbaresa,* *vij,*
drodh – tema *-a – mbaresa,* *dredh,*
dol – tema *-a – mbaresa,* *dal,*
shtro – tema *-nin – mbaresa,* *shtroj,*
shih – tema , *-ja – mbaresa,* *shoh,*
puno – tema *-va – mbaresa,* *punoj.*

Në disa fjalë tema nuk ndryshon (*lajmërojmë, nxitonte, shtronin, punova*), në disa të tjera pëson ndryshime fonetike (*mbillni, drodha, dola, shihja*) dhe në të tjera ndryshon tërësisht (*ardhur*).

5. *djal – tema* *-in – mbaresa,* *djalë,*

vajz(ë) – tema	-at – mbaresa,	vajzë
kod(ë)r – tema	-ës – mbaresa,	kodër,
punëtor – tema	-ë – mbaresa,	punëtor,
mot(ë)r – tema	-a – mbaresa,	motër,
miq – tema	-të – mbaresa,	mik,
shkollë – tema	-n – mbaresa,	shkollë,
desh – tema	-ve – mbaresa,	dash,
mal – tema	-esh – mbaresa,	mal,
gog(ë)l – tema	-at – mbaresa,	gogël.

Në disa fjalë tema nuk ndryshon (*djal***in**, *vajz***at**, *punëtor***ë**, *shkoll***ën** *malesh*), në disa të tjera pëson ndryshime fonetike (*miq***të**, *desh***ve**) dhe në të tjera pëson rënie tingujsh (*kodr***ës**, *mo***tra**, *gog***lat**).


6. (feste**e**, rrugic**ën**, mbush**ur**, trëndafil**at**, vjollc**at**, tërhiq**nin**, vëmendj**en**, kalimtar**ëve**, përrall**a**, sken**e**, shndrist**e**, mbush**ur**, qeshj**et**, arom**ën**, tort**ës**, qëndront**e**, salloni**t**, ngjy**rat**, gëzim**i**, zem**ra**, rrëshqit**ur**, dit**e**, ditëlindj**ej**e, jet**ën**, lën**ë**, fëmijëris**ë**, ëm-bëlsin**ë**, adoleshenc**ës**, shok**ët**, mbledh**ur**, shpërndan**in**, urime**e**, përqa**fime**)


2. PËRBËRËSIT E FJALËS

1. Rrënja, parashtesa, prapashtesa.

2. <i>punoj</i>	<i>punë,</i>	<i>përemër</i>	<i>emër,</i>
<i>ndërpres</i>	<i>pres,</i>	<i>patok</i>	<i>patë,</i>
<i>plugoj</i>	<i>plug,</i>	<i>trimëri</i>	<i>trim,</i>
<i>përmirësoj</i>	<i>mirë,</i>	<i>bardhësi</i>	<i>(i) bardhë,</i>
<i>shfrytëzoj,</i>	<i>fryt</i>	<i>pranim,</i>	<i>pranë.</i>

Fjala	parashtesa	prapashtesa	mbaresa
<i>ndriçimin</i>	-	<i>-im</i>	<i>-in</i>
<i>jetonte</i>		<i>-o</i>	<i>-nte</i>
<i>punëtor</i>		<i>-tor</i>	
<i>ëndërronte</i>		<i>-o</i>	<i>-nte</i>
<i>ëndërrimtar</i>		<i>-im, -tar</i>	
<i>trimërisht</i>		<i>-ëri, -sht</i>	
<i>makineri</i>		<i>-eri</i>	
<i>shndriste</i>	<i>sh-</i>	-	<i>-te</i>
<i>ndërprerje</i>	<i>ndër-</i>	<i>-je</i>	
<i>përqeshnin</i>	<i>për-</i>	-	<i>-nin</i>
<i>përkrahnin</i>	<i>për-</i>	-	<i>-nin</i>
<i>bujarisht</i>		<i>-isht</i>	
<i>përfundoi</i>	<i>për-</i>	<i>-o</i>	<i>-i</i>
<i>e fuqishme</i>		<i>-sh(ë)m</i>	<i>-e</i>
<i>festoi</i>		<i>-o</i>	<i>-i</i>
<i>punëtorëve</i>		<i>-tor</i>	<i>-ëve</i>
<i>shkëlqimin</i>		<i>-im</i>	<i>-in</i>





5.

TEMA			MBARESA
parashtesa	rrënja	prapashtesa	
<i>për-</i>	<i>pun(ë)</i>	<i>-o</i>	<i>-jmë</i>
<i>për-</i>	<i>mbledh</i>	<i>-je</i>	<i>-n</i>
	<i>këmbë</i>	<i>-sor</i>	<i>-ët</i>
	<i>(i) lumtur</i>	<i>-i</i>	<i>-sht</i>
<i>ç-</i>	<i>arma</i>	<i>-tos; -je</i>	<i>-n</i>
<i>mbi</i>	<i>ngark(o)</i>	<i>-esë</i>	<i>-n</i>
<i>z-</i>	<i>(i) bardh(ë)</i>	<i>-je</i>	<i>-n</i>
<i>stër-</i>	<i>mund</i>	<i>-o</i>	<i>-jnë</i>
	<i>(i) lir(ë)</i>	<i>-i; -sht</i>	

Fjala	Tema	Temë fjalëformuese	Temë fjalëformuese	Temë fjalëformuese
<i>përmbledhjen</i>	<i>përmbledhje</i>	<i>përmbledh</i>	<i>mbledh</i>	
<i>këmbësorët</i>	<i>këmbësor</i>	<i>këmbë</i>		
<i>lumturisht</i>	<i>lumturisht</i>	<i>lumturi</i>	<i>i lumtur</i>	
<i>çarmatosjen</i>	<i>çarmatosje</i>	<i>çarmatos</i>	<i>armatos</i>	<i>armë</i>
<i>mbingarkesën</i>	<i>mbingarkesë</i>	<i>ngarkesë</i>	<i>ngarko</i>	
<i>zbardhjen</i>	<i>zbardhje</i>	<i>zbardh</i>	<i>i bardhë</i>	
<i>stërmundojnë</i>	<i>stërmundo</i>	<i>mando</i>	<i>mund(i)</i>	
<i>lirisht</i>	<i>lirisht</i>	<i>liri</i>	<i>i lirë</i>	

3. FJALË TË PARME DHE JO TË PARME

1.

2.

Fjalë të parme	Fjalë jo të parme
<i>kohë</i>	<i>të largët</i>
<i>shtëpi</i>	<i>të artë</i>
<i>të vogël</i>	<i>vendosi</i>
<i>pyllit</i>	<i>të fshehur</i>
<i>sy</i>	<i>këmbëshpejtë</i>
<i>flokë</i>	<i>zëëmbël</i>
<i>dielli</i>	<i>punëtore</i>
<i>thesar</i>	<i>mahnitëse</i>
<i>kafshë</i>	<i>kërkimin</i>

lepur	i shndritshëm
era	të çmuara
zog	e rëndësishme
milingonë	e mrekullueshme
arriti	banorëve
shpellë	vizatimeve

3. *lir(o)* – im (me prapashtesim), *përshtëndet* – je (me prapashtesim),
i pa – larë (me parashtesim), *punë* – mbarë (me përbërje),
kalim – thi (me prapashtesim), *ndaj* – folje (me parashtesim),
sh – fryt – ëzo(j) (me parashtesim dhe prapashtesim njëkohësisht),
at – dhe (me përbërje), *cili* – do (me përngjitje),
i liruar (me paranyjëzim), *letër* – këmbim (me përbërje),
ri – ndërtim (me parashtesim), *kurr* – farë (me përngjitje).

4.

Fjala	Tema fjalëformuese
<i>punoj</i>	<i>punë</i>
<i>kombëtar</i>	<i>komb</i>
<i>largim</i>	<i>largo</i>
<i>zemërngushtë</i>	<i>zemër + (i) ngushtë</i>
<i>fshatarësi</i>	<i>fshatar</i>
<i>përpunoj</i>	<i>puno</i>
<i>zmadhoj</i>	<i>i madh</i>
<i>i harruar</i>	<i>harro</i>

5.

Të parme	Të prejardhura	Të përbëra	Të përngjitura
<i>dritë</i>	<i>përfytyro</i>	<i>bregdet</i>	<i>nëntëmbëdhjetë</i>
<i>mal</i>	<i>përbalt</i>	<i>rrobaqepës</i>	<i>cilido</i>
<i>zog</i>	<i>përrallor</i>	<i>fatkeq</i>	<i>mirëmbërma</i>

6.

a. *përdor* për (parashtesa) – dor(ë) (rrënja)

Tema *përdor*, e formuar me parashtesim nga tema fjalëformuese *dor(ë)*;
dorë temë e parme.

b. *përbëja* për (parashtesa) – bëj (rrënja) – a (mbaresa);

Tema *përbëj*, e formuar me parashtesim nga tema fjalëformuese *bëj*;
bëj temë e parme.

c. *përbuzje* për (parashtesa) – buz(ë) (rrënja) – je (prapashtesa)

Tema *përbuzje*, e formuar me prapashtesim nga tema fjalëformuese *përbuz*;

përbuz, e formuar me parashtesim nga tema fjalëformuese *buz(ë)*;

buzë temë e parme.

d. *largonin larg (rrënja) – o (prapashtesa) – nin (mbaresa)*;

Tema *largo*, e formuar me prapashtesim nga tema fjalëformuese *larg*;

larg temë e parme.

e. *udhëtimeve udhë (rrënja) – t(o) (prapashtesa) – im (prapashtesa) – eve (mbaresa)*

Tema *udhëtim*, e formuar me prapashtesim nga tema fjalëformuese *udhëto*;

udhëto, e formuar me parashtesim nga tema fjalëformuese *udhë*;

udhë temë e parme.

f. *mendjelehtë mendje (rrënja) – (e) lehtë (rrënja)*

Tema *mendjelehtë*, e formuar me përbërje nga temat fjalëformuese *mendje* dhe *(e) lehtë*;

mendje temë e parme dhe *(e) lehtë* temë e parme.

7. **vendbanim** **vend + banim,**

syshqiponjë **sy + shqiponjë,**

zemërdhembshur **zemër + (e) dhembshur,**

buzëqeshte **buzë + qesh,**

mendjehapur **mendje + (e) hapur,**

pendartë **pend(ë) + (e) artë.**

8. **posa** **me përngjitje (po + sa)**

kushdo **me përngjitje (kush + do)**

megjithëse **me përngjitje (me + gjithë + se)** **lidhëz,**

asnjë **me përngjitje (as + një)** **përemër i pacaktuar,**

askush **me përngjitje (as + kush)** **përemër i pacaktuar,**

dikur **me përngjitje (di + kur)** **ndajfolje,**

përherë **me përngjitje (për + herë)** **ndajfolje,**

tekdo **me përngjitje (tek + do)** **ndajfolje,**

nëse **me përngjitje (në + se)** **lidhëz,**

gjithmonë **me përngjitje (gjithë + mo(t)në)** **ndajfolje.**

1. TELEFONI

1. a. Një nga mjetet e rëndësishme të komunikimit midis njerëzve është edhe telefoni.
b. Fjala *telefon* rrjedh nga greqishtja: *tele* (larg) dhe *phone* (zë), që do të thotë “zë i largët”.
2. 1860.
3. Aleksandër Graham Bell ishte i pari që mori një patentë për telefonin elektrik nga Zyra e Patentave dhe e Markave në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
4. Satelitët përdoren për të përcjellë valët telefonike.
5. Celulari, është një aparat komunikimi për telefoninë e lëvizshme, që lidhet me rrjetin telefonik të tokës nëpërmjet stacioneve të ndryshme të komunikacionit.
6. Shpikës i celularit ishte inxhinieri amerikan Martin Kuper.
7. Celulari i tij peshonte 1 kg dhe kishte 40 minuta bateri.
8. Shkrimtari francez Fil Marso, më 6 shkurt 2001, hodhi idenë e një dite botërore pa celular.

2. BISEDË TELEFONIKE

1. a. Me kalimin e kohës telefonat filluan të ndryshojnë dhe komunikimi telefonik u përmirësua në vazhdimësi.
b. Mënyra e të folurit varet nga situata apo personi të cilit i telefonojmë.
2. b. Përparimi teknologjik nuk nënkupton patjetër edhe përparim në marrëdhëniet njerëzore.
3. Në ditët e sotme kemi në përdorim telefonat inteligjentë, bile edhe orët inteligjente, me ndihmën e të cilave mund të kontaktojmë me cilindo.
4. Një bisedë telefonike zhvillohet në formën e një dialogu.

3. LLOJET E BISEDAVE TELEFONIKE

1. Dallojmë dy lloje kryesore bisedash telefonike: *zyrtare* (formale) dhe *private* (joformale).
2. a. Biseda telefonike zyrtare (formale) është një bisedë që zhvillohet midis dy personave për çështje pune.
b. Biseda telefonike private (joformale) zakonisht është një bisedë telefonike e zhvilluar midis dy të afërmve, të njohurve apo miqve

4. KLASAT E FJALËVE

1. 1. Emri. 2. Mbiemri. 3. Përemri. 4. Numërori. 5. Folja. 6. Ndajfolja. 7. Lidhëza. 8. Parafjala. 9. Pjesëza. 10. Pasthirmja.

2. Në një mëngjes pranveror, kur dielli përqaftonte me rrezet e tij gjithë oborrin e shkollës, një grup nxënësish me çantat e tyre plot ngjyra dhe me kapelet e diellit në kokë, u grumbulluan plot zhurmë pranë autobusit të madh blu. Mësuesja, me një buzëqeshje të ngrohtë në fytyrë, mbante një listë në dorë dhe lexonte me radhë emrat e nxënësve. Fëmijët, të mbushur me kënaqësi të pakrahasueshme, hipnin gëzueshëm në autobus.

Ekskursioni i shkollës për në parkun kombëtar ishte një ngjarje e shumëpritur nga fëmijët. Mbërritja në parkun kombëtar shënoi fillimin e një dite të mbushur me zbulime; nga shëtitja nëpër shtigjet e ngushta e plot gjelbërim të pyllit, mësimi për bimët dhe kafshët e zonës, te vrojtimi i zogjve me dylbi. Bisedat plot gjallëri dhe këngët e fëmijëve ndërthureshin hareshëm me tingujt e natyrës.

Pikniku në barin e gjelbër, i shoqëruar me të qeshurat gazmore të fëmijëve dhe me historitë fantastike të mësuesve, bënë që kjo shëtitje të përjetohej me kënaqësi.

(me të kuqe janë shënuar fjalët e ndryshueshme, me blu fjalët e pandryshueshme)

3.

Emër	Mbiemër	Përemër	Numëror	Folje	Ndajfolje	Lidhëz	Parafjalë	Pjesëz	Pasthirmë
moti	i bukur	ata	tre	mbështjell	afër	se	nga	ja	ohoho
retë	e heshtur	yt	tridhjetë	flas	larg	sepse	në	nuk	hej
shiu	faqekuq	ynë	dhjetë	them	këtu	dhe	nëpër	mos	qyqja
përmbytje	i ri	ne	pesëdhjetë	laj	shpejt	por	prej	jo	oh
		këto			vonë	kurse			
		juaj							

4. *dhe, sikur, që, as, sepse, sesa, kur, **ju** lidhëza,
 * vrapoj, zgjohem, luaj, përshëndes, **dje** folje,
 * i freskët, **përparim**, i dashur, dimëror mbiemër,
 * jo, po, sapo, jo që jo, **prej** pjesëza.

5.

Emër	Mbiemër	Përemër	Numëror	Folje	Ndajfolje	Lidhëz	Parafjalë	Pjesëz	Pasthirmë
deti	e lodhura	të tyre	dy	lëpinin	fort	sikur	nga	nuk	obobo
i stuhisë	llokoçitëse	ai		kishin mbetur	afër	por	prej		
shkumën	e rreshkur	e tij		thoshte			nga		
	e vjetër	ime							

6. a. numëror; b. mbiemër; c. emër; d. parafjalë; e. folje; f. ndajfolje; g. emër; h. parafjalë; i. lidhëz; j. përemër; k. përemër.

7. uaa pasthirmë lumin emër
 bukuri emër Cemit emër
 të rrallë mbiemër që lidhëz
 me parafjalë përshkon folje

male	emër	ato	përemër,
dhe	lidhës	kodra	emër
të veshura	mbiemër	pyje	emër
kanë	folje	fshatrat	emër
Malësisë	emër	së Tuzit	emër

1. EMRI

1. a. Emri është ajo klasë fjalësh që emërton qenie të gjalla apo sende.
 - b. Emrat gjithashtu mund të emërtojnë edhe: dukuri të natyrës, veprime, tipare dhe nocione abstrakte.
 - c. emra të përgjithshëm dhe emra të përveçëm.
- 2.

Frymorë	Sende	Dukuri (veprime, tipare, nocione)
djalë	fshat	histori
vajzë	mali	pasion
shokë	lapsin	leximin
djaloshi	libër	mëngjes
vajza	dorë	sekretet
grua	e malit	mençurinë
të rinjve	e fshatit	mesazh
dele	thesar	mirësinë
bari	thesari	të vërtetat
kalë	argjend	e jetës
	ar	
	fushave	
	fushën	

3.

Emra të përgjithshëm	Emra të përveçëm
<i>udha</i>	<i>Saranda</i>
<i>kthesa</i>	<i>Struga</i>
<i>liqeni</i>	<i>Hani i hotit</i>
<i>pisha</i>	<i>Dinosa</i>
<i>shkolla</i>	<i>Adriatiku</i>
<i>rrjeta</i>	<i>Cemi</i>
<i>peshkatari</i>	<i>Tirana</i>
<i>vala</i>	<i>Plava</i>
<i>pushimi</i>	<i>Moraça</i>
<i>molla</i>	<i>Azia</i>
<i>portokalli</i>	<i>Tuzi</i>
<i>era</i>	<i>Taraboshi</i>
<i>druri</i>	<i>Gucia</i>
<i>kështjella</i>	
<i>kënga</i>	
<i>poezia</i>	
<i>tigri</i>	
<i>kujtimi</i>	
<i>vazoja</i>	

4.

3 emra qytetesh	Ulqin, Tivar, Podgoricë
3 emra shtetesh	Mali i Zi, Shqipëria, Kosova
3 emra kontinentesh	Azia, Amerika, Evropa
3 emra malesh	Rumia, Mozhuri, Dajti
3 emra lumenjsh	Buna, Drini, Cemi
3 emra revistash	"Studime filologjike", "Gjuha jonë", "Malësia"
3 emra hotelesh	"Albatros", "Otrant", "Kulla e Balshajve"
3 emra rrugësh	"Mujo Ulqinaku", "Nënë Tereza", "Skënderbeu"
3 emra gazetash	"Ulqini", "Koha ditore", "Koha javore"

5.

Konkret	Abstrakt	Përmbledhës	Lëndor
<i>det</i>	<i>lëvizje</i>	<i>djalëri</i>	<i>grurë</i>
<i>qytet</i>	<i>vrapim</i>	<i>grari</i>	<i>qumësht</i>
<i>shkollë</i>	<i>mendim</i>	<i>drizëri</i>	<i>benzinë</i>
<i>mal</i>	<i>liri</i>		<i>alkool</i>
<i>njeri</i>	<i>dyshim</i>		<i>squfur</i>
<i>lopë</i>	<i>trimëri</i>		<i>nitrat</i>
<i>shtëpi</i>	<i>kujtesë</i>		
<i>libër</i>			
<i>fletore</i>			
<i>shtrat</i>			
<i>tryezë</i>			
<i>këpucë</i>			
<i>makinë</i>			

6.

- i ulët ultësi, femërore,
- lexo lexim, mashkullorë, lexo të lexuarit, asnjënjë,
- i prapë prapësi femërore,
- puno punim mashkullorë, punotë punuarit asnjënjë,
- i shpejtë shpejtësi femërore,
- i lartë lartësi femërore,
- largo largim mashkullorë, largotë larguarit asnjënjë,
- i largët largësi femërore,
- thello thellim mashkullorë,
- i thellë thellësi femërore.

7.

vajzë vajza vajzëria,
vëlla vëllezër vëllazëria,
fisnik fisnikë fisnikëria,
punëtor punëtorë punëtoria,
i parë të parë paria,
kalorëskalorës kalorësia.

8. Lexoni tekstin dhe nënvizoni emrat: ndajini në gjini sipas tabelës së dhënë.

Në vend të **sqepit** kishin **gojë** si **të qenit**, **krahët** u ishin shndërruar në **gjymtyrët** e para, që nuk dukeshin as si **këmbë**, as si **duar**, por diçka në mes; kurse në vend të **puplave** kishin **qime** si **të dhëlpërës**, por të zeza dhe pak më të rralla. Për çudi, **këmbët** dukeshin si **të njeriut**, me **kthetra** si **të fajkoit**. Kishin edhe dy **veshë** si **të hutit**. **Barkun** e kishin të madh në krahasim me **trupin**, ndërsa bishtin cubel. Këso **krijese** nuk ke parë kurrë, **biri** im...

Në **parkun** qendror **të qytetit** tonë **stolat** janë gjithmonë të mbushur me **njerëz**. Pemët janë plot me **zogj**. **Të shikuarit** e tyre ishte kthyer në një **zakon** për ne. Një **ditë**, ndërsa po shëtisja, dëgjova **tingujt e këngës** së një **zogu** të vogël. **Të kënduarit** e tij ishte i veçantë. Ne u ulëm në një **stol** që të shijonim **këngën** e tij.

Pranë nesh erdhi një **qen** i vogël, i cili nuk po qetësohej, mbasi përballë kishte një **mace** të vetmuar, që dridhej nga **të ftohtit** dhe kishte **vështirësi** në **të ecur**. **Kafshët**, me **mënyrat** e tyre të ndryshme **të jetesës**, na mësojnë mbi **pasurinë** dhe **diversitetin e botës** që na rrethon.

Emra të gjinisë mashkullore	Emra të gjinisë femërore	Emra të gjinisë asnjane
sqepit	gojë	të shikuarit
të qenit	gjymtyrët	të kënduarit
krahët	këmbë	të ftohtit
të njeriut	duar	të ecur
të fajkoit	puplave	
veshë	qime	
të hutit	të dhelpres	
barkun	këmbët	
trupin	kthetra	
biri	krijese	
parkun	ditë	
të qytetit	e këngës	
stolat	këngën	
njerëz	mace	
zogj	vështirësi	
zakon	kafshët	
tingujt	mënyrat	
zogu	të jetesës	
stol	pasurinë	
qen	e botës	
diversitetin		

- | | | | |
|------------|--------------|-----------------|-----------|
| 1. agronom | agronome, | luan | luaneshë, |
| shofer | shofere, | piktor | piktore, |
| prift | priftëreshë, | dash | dele, |
| ulqinak | ulqinake, | nxënës | nxënëse, |
| aktor | aktore, | bari | bareshtë, |
| futbollist | futbolliste, | kunat | kunatë, |
| bujk | bujkeshë, | kalë | pelë. |
| 2. shi | i lehtë | shira të lehtë, | |

ngjarje	e rëndë	ngjarje të rënda,
mendim	i lirë	mendime të lira,
erë	e freskët	erëra të freskëta,
makinë	e vogël	makina të vogla,
vend	i bukur	vende të bukura,
tregim	i mirë	tregime të mira,
shkollë	e madhe	shkolla të mëdha,
ujë	i nxehtë	ujëra të nxehta.

(emrat *shi, mendim, vend, tregim, ujë* kanë ndërruar gjininë në numrin shumës).

- | | | | |
|-----------|---------------|----------|--------------|
| 3. shkuar | të shkuarit, | i lexuar | të lexuarit, |
| ardhur | të ardhurit, | i verdhë | të verdhët, |
| kthyer | të kthyerit, | i zi | të zitë, |
| mbuluar | të mbuluarit, | i ftohtë | të ftohtit, |
| punuar | të punuarit, | i nxehtë | të nxehtit. |

4.

Emra në numrin njëjës	Emra në numrin shumës
Lepurushi	rrezet
të diellit	putrat
sfungjer	putrat
Lepurushi	rrezet
zemër	mustaqet
shishja	antena
e bojës	të veshëve
së shkrimit	e detyrave
fletoren	lotët
të matematikës	pikëza
shtrati	sytë
dritare	
shelgut	
pallua	
argjendi	

kadifenë	
bari	

5. (Fjalët me shkronja të zeza janë fjalë që përdoren vetëm në numrin shumës).

6. mur	mure,	vjershë	vjersha,
pishë	pisha,	varg	vargje,
breshkë	breshka,	shteg	shtigje,
yll	yje,	pikë	pika,
liqen	liqene,	dorë	duar,
dallgë	dallgë,	rrjetë	rrjeta,
fletore	fletore,	vesh	veshë,
shok	shokë,	vijë	vija,
fushë	fusha,	libër	libra,
gol	gola,	oborr	oborre.

7. (fshatra, vendbanime, gërmimet, banorët, drithëra, bimë, fshatrat, qytetet, turistëve, bukuritë, malet, kodrat, pyjet, burimet, ujëra, banorët, pasuri, shekuj)

8. Qytetarët ulqinakë të Malit të Zi njihen për mikpritje nga turistët.

Netët vjeshtore vijnë të freskëta në Tuz.

Në Panairin e Librit mbizotëronin veprat e shkrimtarit Ismail Kadare.


Në qiell u shfaqën papritur hijet e ca zogjve në fluturim.

Shokët e mi të klasës folën gjatë për pushimet verore.

Nuk i dija oraret e takimeve të Ligës evropiane për sot.

2. LAKIMI I EMRAVE

1. Emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.



3. Një këmbë e ka në varr! S'i kishte mbetur fuqi as t'i lëvizte duart. Vetëm ndonjë fjalë e copëtonte, por nuk i kuptohej. Mendohej të më thoshte diçka. Të folurit po i ndalej. Lëvizte buzët dhe rrudhte fytyrën e ballin. Për të mësuar çka donte të shprehte, iu qasa dhe ia vura veshin te goja.

"Amanet po t'i lë fëmijët: Janë të vegjël e jetimë e nuk ka kush të kujdeset për ta. Te askush tjetër nuk kam besim, vetëm në ty. Ti je miku im më i mirë..." dhe zëri iu shterr. Pastaj pëshpëriti diçka nëpër buzë. Nëpër dy anët e syve i rrodhën lotët e fundit që i kishin mbetur. M'u duk sikur ata u shndërruan në grumbuj zjarri, që rridhnin nëpër faqet e mia dhe më digjnin. I mendova fëmijët pa shokë e miq në jetë.

Lakimi I	Lakimi II	Lakimi III	Lakimi IV
varr	miku	këmbë	të folurit
ballin	shokë	fuqi	
veshin	miq	duart	
amanet		fjalë	
besim		buzët	
zëri		fytyrën	
e syve		goja	
lotët		fëmijët	
grumbuj		buzë	
zjarri		faqet	
		fëmijët	
		jetë	

4. (Lis) Lisin e madh në ballë të (pyll) pyllit, drunjtë e tjerë e duan vetëm kur u ndalon (erë)

erërat e forta apo (rrufe) rrufetë. Por, kur situata qetësohet, gjithkujt i bëhet pengesë. Disa i pengon (vjetërsi) vjetërsia e tij. Disa ia kanë zili (trup) trupin e drejtë e të palakuar, të tjerëve u bën hije. Dikë e pengon (mishërim) mishërimi i (rrënjë) rrënjëve të tij të trasha me (tokë) tokën dhe (shkëmb) shkëmbinjtë përreth. Të gjithë pengohen, duke filluar prej (dru) drurëve më të afërm deri tek (dru) drurët më të largët.

Lisin	kallëzore,
të pyllit	gjinore,
erërat	kallëzore,
rrufetë	kallëzore,
vjetërsia	emërore,
trupin	kallëzore,
mishërimi	emërore,
i rrënjëve	gjinore,
tokën	kallëzore,
shkëmbinjtë	kallëzore,
drurëve	rrjedhore,
drurët	emërore.

5.

Trajta e shquar				
Numri njëjës				
<i>Rasa</i>	<i>top</i>	<i>shok</i>	<i>vajzë</i>	<i>të ecurit</i>
Emërore	topi	shoku	vajza	të ecurit
Gjinore	i, e topit	i, e shokut	i, e vajzës	i, e të ecurit
Dhanore	topit	shokut	vajzës	të ecurit
Kallëzore	topin	shokun	vajzën	të ecurin
Rrjedhore	topit	shokut	vajzës	të ecurit

6.

Trajta e shquar			
Numri shumës			
Rasa	top	shok	vajzë
Emërore	topat	shokët	vajzat
Gjinore	i, e topave	i, e shokëve	i, e vajzave
Dhanore	topave	shokëve	vajzave
Kallëzore	topat	shokët	vajzat
Rrjedhore	topave	shokëve	vajzave

7.

qytet	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa kallëzore, trajta e shquar, lakimi I;
Adriatikut	emër i përveçëm, konkret, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa rrjedhore, trajta e shquar, lakimi II;
vajzë	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia femërore, numri njëjës, rasa emërore, trajta e shquar, lakimi III;
misteret	emër i përgjithshëm, abstrakt, gjinia femërore (ndërron gjini në numrin shumës), numri shumës, rasa kallëzore, trajta e shquar, lakimi I;
e bashkëmoshtarëve	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri shumës, rasa gjinore, trajta e shquar, lakimi I;
telefonat	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri shumës, rasa kallëzore, trajta e shquar, lakimi I;

Marina	emër i përveçëm, konkret, gjinia femërore, numri njëjës, rasa emërore, trajta e shquar, lakimi III;
kohën	emër i përgjithshëm, abstrakt, gjinia femërore, numri njëjës, rasa kallëzore, trajta e shquar, lakimi III;
shëtitjeje	emër i përgjithshëm, abstrakt, gjinia femërore, numri njëjës, rasa rrjedhore, trajta e pashquar, lakimi III;
qelibar	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa kallëzore, trajta e pashquar, lakimi I;
peshqit	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri shumës, rasa emërore, trajta e shquar, lakimi II;
sirena	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia femërore, numri shumës, rasa kallëzore, trajta e pashquar, lakimi III;
zbulim	emër i përgjithshëm, abstrakt, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa kallëzore, trajta e pashquar, lakimi I;
çelësi	emër i përgjithshëm, konkret, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa emërore, trajta e shquar, lakimi I;

1. REKLAMA

1. Reklama është çfarëdo shpalljeje publike e cila rekomandon e thekson cilësitë e mira të një prodhimi apo shërbimi, shtyn përpara ndonjë ide apo çështje, me qëllim që t'i bëjë tërheqëse për konsumatorët e mundshëm.
2. T'i bindë të tjerët për atë që reklamon.
3. 1. Të informojë; 2. Të bindë; 3. Të kujtojë.
4. Reklamën që transmetohen nëpërmjet televizionit.

2. KARAKTERISTIKAT DHE ELEMENTET E REKLAMËS

1. Reklamën synojnë të kenë një audiencë të caktuar sipas rastit, gjithmonë në varësi të gjinisë, moshës, kulturës, shijeve etj. të klientëve të mundshëm.
2. Kreativiteti, qartësia, tërheqja, emocionaliteti, rrjedha logjike, kohëzgjatja.
3. Të kuptojmë se çfarë u pëlqen atyre, çfarë informacioni është i rëndësishëm për ta dhe se si ata do ta përdorin produktin apo shërbimin e ofruar.

3. HISTORIA E REKLAMËS

1. Deri në shpikjen e shtypshkronjës, reklamimi i mallrave dhe i ngjarjeve në pjesën më të madhe kryhej përmes komunikimit gojor.
2. Tellallët.
3. a. reklamonte librat e shtypura nga shtypshkronja e tij;
4. Përmes dy kanaleve kryesore të komunikimit:
gazetave, ku reklamat fillojnë të shfaqen gjithnjë e më shpesh;
posterave, ku përzihen imazhet, fjalët dhe ngjyrat.
